

Kumbona e së Diellës



Fotograf Giuseppe Massani, 1940. - "Kisha e Shën Ilisë - Berdicë"

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.1/2, Janar - Shkurt 2020

E DIELA E FJALËS SË HYJIT

“Kremtimi i së dielës së Fjalës së Hyjit shpreh një vlerë ekumenike”

E themeluar nga Papa Françesku me Letrën Apostolike në formën e “Motuproprio” e datës 30 shtator 2019, E diela e Fjalës së Hyjit është kremtuar edhe në Arkidioqezën e Shkodër-Pultit. Arqipeshkvi Angelo Massafra, duke udhëhequr kremtimin eukaristik, fillimisht në kishën e Shën Kollit e pastaj në kishën e Dom Boskos, ka dëshiruar që të intronizohej libri i Fjalës së Hyjit i sjellë në mënyrë solemne gjatë procesionit të hyrjes në Meshë.

Nuk bëhet fjalë vetëm për një rit të jashtëm, por për pikënisjen e një tradite që ka si qëllim të sensibilizojë besimtarët katolikë në lidhje me dy aspektet e dy ngjarjeve që çdo vit bien në këtë periudhë të vitit: Java e Lutjes për Bashkimin e të Krishterëve dhe dita e Dialogut të Kishës katolike me popullin hebraik.

E diela e tretë e kohës gjatë vitit nuk është një kohë çfarëdo, por, saktëson Papa Françesku, vendoset “në një moment të përshtatshëm të asaj periudhe të vitit, kur jemi të ftuar t'i forcojmë lidhjet me hebrenjtë dhe të lutemi për bashkimin e të krishterëve”. Jo “një koinçidencë e thjeshtë kohore”. Kremtimi i së dielës së Fjalës së Hyjit shpreh një vlerë ekumenike, sepse Shkrimi i shenjtë u tregon atyre që vihen në dëgjim ecjen që duhet të bëjnë për të arritur në një bashkim të njëmendtë e të qëndrueshëm”.

Gjithashtu, themelimi i kësaj të diele, për zemrën e Papës, është edhe një mënyrë më e fortë për të sensibilizuar bashkësitë e krishtera që “të përgatisin disa besimtarë për të qenë shpallës të vërtetë të fjalës me një përgatitje të përshtatshme” ndërsa, drejtuar priftërinjve thotë: “Në të vërtetë, për shumë prej besimtarëve tanë ky është i vetmi rast që kanë për të kuptuar bukurinë e Fjalës së Hyjit dhe për ta parë atë të referuar në jetën e tyre të përditshme. Prandaj është e nevojshme që të kushtohet koha e duhur për përgatitjen e homelisë. Nuk mund të improvizohet komenti i leximeve të shenjta”.

Le të jetë kjo edhe për Kishën tonë një ngjarje që bart në vete atë përtëritje aq të dëshiruar e të shpresuar, duke e bërë Fjalën e Hyjit zemër të çdo reflektimi, zgjedhjeje dhe të vendimi tonë.





Mons. Angelo Massafra KUMBONA E DIELËS	4
R.SH. Vatikan PAPA FRANÇESKU: TË MENDOSH PËR ARSIMIN	5
Don Nosh Gjolaj NDIKIMI SOCIAL SI DHE TERAPIA GRUPALE	7
Jean-Pierre Sonnet S.I SECILI ÇIFT	10
CCEE/COMECE IDEOLOGJIA E NACIONALSOCIALIZMIT	14
Atë Landi Jaku OFM JEMI NE ATA QË E DËGJOJMË FJALËN E ZOTIT	17
Evalda Paci Atë BENEDIKT DEMA	18
Redaksia DIALOGU	21
Majk Mila DITA BOTËRORE E PAQES	22
Tomë Mrijaj TË MËDHENJTË E KOMBIT	23
Tonin Çobani TË MËDHENJTË E KOMBIT	26
Loreta Tomaj MIKPRTJA E NJË POPULLI QË KËRKON LIRI	27
VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELËS
Viti XXXIII, nr. 1/2 (527-528) Janar - Shkurt 2020

<u>Revistë</u> Fetaro-Kulturore <u>Drejtues</u> Imzot Angelo MASSAFRA	<u>Redaksia</u> Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor) Dom Vlash Palaj Dom Gjovalin Simoni	<u>Adresa:</u> Arqipeshkvia Shkodër Sheshi Gjon Pali II Tel. 0222-42764 Fax. 0222-43673 e-mail: n_ukgjini@yahoo.it Web page: kishakatolikeshkoder.com
--	---	--

Redaktor teknik: Xhon Nika

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

KUMBONA E DIELËS MJET KOMUNIKIM I PËRBASHKËT

Gjatë këtyre 20 viteve kanë parë dritën e botimit 147 numëruat të Fjalës së Paqes



*Qe, Virgjëra
do të mbesë shtatëzënë
e do të lindë një djalë,
të cilit do t'ia ngjeshin
emrin Emanuel -
që do të thotë:
Hyji me ne!
Mt. 1, 23*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 4 (147) Viti XXI Tetor - Dhjetor 2019**

Para 20 vite më përpara, me rastin e 25-vjetorit të shugurimit tim meshtarak, do lindte revista dioqezane “Fjala e Paqes”, një mjet komunikimi përmes të cilit në çdo kënd të Arqidioqezës sonë do të arrinin lajmet e jetës dioqezane, të dobishme për bashkendarjen më të tjerët, por sidomos të ideve dhe të linjave baritore.

Gjatë këtyre 20 viteve kanë parë dritën e botimit 147 numerat të Fjalës së Paqes dhe materiali i mbledhur dhe i botuar është një tjetër mjet që tregon historinë e Arqidioqezës sonë, të pasur me ngjarje që, vit pas viti, kanë kontribuar për zhvillimin e këtij realiteti kishtar, i cili rilindi pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri.

Por, siç dihet, kohët ndryshojnë dhe bota është në zhvillim të vazhdueshëm edhe përsa u përket mjeteve të komunikimit. Shtypi në letër edhe pse është një mjet i vlefshëm dhe i qëndrueshëm, gjithsesi është duke kaluar një periudhë krize në kohën e sotme të globalizimit dhe kur ka marrë hovë të madh informacioni elektronik.

Nga ana tjetër, të gjithë, tashmë, nga më i madhi deri te më i vogli, kemi mjete të tilla që, nëse përdoren siç duhet, lehtësojnë komunikimin dhe, pse jo, edhe përhapjen e Lajmit të Mirë të Ungjillit dhe lajmet e tjera të mira që kanë të bëjnë me Kishën.

Për këtë arsye, duke filluar prej vitit 2020 informacioni dioqezan do të kalojë nëpërmjet një organi të vetëm shtypi zyrtar dhe kjo është revista “Kumbona e Dielës” e botuar së pari herë në vitin 1938, e ku, përveç ngjarjeve kulturore, tipike për këtë revistë, aty do të gjenden edhe informacionet që deri tani ishin ekskluzive të revistës “Fjala e Paqes”.

Por edhe këtu do të ketë një risi: kopjet e shtypura do të jenë aq sa do të jenë edhe kërkesat që do të mbërrijnë në Redaksi. Nga ana tjetër, përhapja

e Revistës dioqezane do të bëhet edhe përmes kanaleve elektronike me kërkesë të të interesuarve dhe, siç ndodh edhe tani, ajo do të hidhet edhe në Sitin e Arqidioqezës, aty ku ndodhen edhe numrat e vjetër të këtyre dy revistave.

Uroj që kjo gjë të mos ulë vëmendjen ndaj jetës dhe veprimtarive të Kishës sonë vendore: është detyrë e Ipeshkvit dhe e meshtarëve ajo që t'i informojnë besimtarët, por është detyrë edhe e çdo besimtari ajo që ai vetë të informohet dhe të marrë pjesë në jetën kishtarë, në mënyrë të përgjegjshme.

Nga ana ime dhe e Redaksisë jemi të gatshëm që t'i mirëpresim sugjerimet tuaja, të cilat mund t'i dërgoni me qëllim që ta përmirësojmë këtë shërbim kaq të rëndësishëm.

Ju bekoj me gjithë zemër.

† **Angelo Massafra O.F.M.**
Arqipeshkëv



PAPA FRANÇESKU: TË MENDOSH PËR ARSIMIN DO TË THOTË TË MENDOSH PËR TË ARDHMEN E NJERËZIMIT

R.SH. – Vatikan

Arsimi është një nga sfidat kryesore me të cilat përballet shoqëria e sotme. Papa Françesku e kujtoi këtë duke pritur pjesëmarrësit në seminarin e promovuar nga Akademia Papnore e Shkencave Shoqërore në përgatitje të takimit botëror “Global Compact on Education”, që do të mbahet në Vatikan, më 14 maj.

akademike, ekonomike, politike e kulturore, për të nënshkruar një “Pakt Global mbi Edukimin”, që secili do të impenjohet ta zbatojë në fushën e vet e do të përpiqet ta përhapë sa më shumë të jetë e mundur.

Edukimi përmes mendjes, zemrës dhe duarve

E sot, në takimin me pjesëmarrësit e seminarit përgatitor për 14 majin, Ati i Shenjtë vuri në dukje



“Çdo brez duhet ta rishikojë transmetimin e njohurive dhe të vlerave për brezin e ardhshëm, sepse vetëm përmes edukimit, njeriu arrin mundësitë e tij maksimale dhe bëhet i vetëdijshëm, i lirë dhe i përgjegjshëm”. Në këtë frazë, Papa Françesku, i cili priti sot pjesëmarrësit në kuvendin me titull “Edukimi: pakti global”, që përfundoi sot në Vatikan, në përgatitje të takimit të rëndësishëm të majit, përmbledhi synimin e diskutimeve dhe të propozimeve, që u dëgjuan dhe e sot në takimin e organizuar nga Akademia Papnore e Shkencave Shoqërore. Kujtojmë se më 14 maj 2020, me nxitjen e Papës Bergoglio, do të mbledhen në Vatikan, përfaqësuesit e feve kryesore, eksponentë të organizmave ndërkombëtare dhe të institucioneve të ndryshme humanitare, të botës

se “të mendosh për edukimin dhe arsimimin, do të thotë të mendosh për brezat e ardhshëm dhe për të ardhmen e njerëzimit, prandaj është diçka e rrënjësuar thellë në shpresë dhe kërkon bujari e guxim”. Si gjithnjë, Papa vuri në dukje idenë e tij të arsimimit, që e ka përsëritur edhe herë të tjera e që përfshin “mendjen, zemrën dhe duart”:

“Duke promovuar mësimin përmes mendjes, zemrës dhe duarve, edukimin intelektual e shoqëro-ro-emocional, transmetimin e vlerave dhe të virtyteve individuale e shoqërore, nxitjen e një qytetarie të impenjuar dhe solidarë me drejtësinë e, duke përçarur aftësi dhe njohuri, që i formojnë të rinjtë për botën e punës e të shoqërisë, familjet, shkollat dhe institucionet bëhen mjete thelbësore për fuqizimin e brezit të ardhshëm”.

Nevojitet një pakt i ri edukativ

Papa Françesku denoncoi mosrespektimin e paktit aktual edukativ, që do të thotë se “si shoqëria, ashtu edhe familja dhe institucionet e ndryshme, të cilat duhet të edukojnë, ua delegojnë këtë detyrë vendimtare edukative të tjerëve”, duke iu ikur përgjegjësisë së tyre. Për një pakt të ri edukativ, nënvizoi Ati i Shenjtë, duhen integruar njohuritë, kultura, sporti, shkenca, argëtimi dhe çlodhja.

“Brezat e rinj duhet ta kuptojnë qartë traditën dhe kulturën e tyre, në marrëdhënie me të tjerat, në mënyrë që të arrijnë ta kuptojnë vetveten, duke u bërë ballë e duke i pranuar dallimet dhe ndryshimet kulturore... [Nevojitet] një edukim, që i bën të aftë të gjejnë dhe të promovojnë vlerat e vërteta njerëzore në një perspektivë ndërkulturore dhe ndërfetare”.

Familja, element thelbësor për përmirësimin e cilësisë së edukimit

Papa Françesku theksoi rolin e rëndësishëm të familjes dhe të bashkësive lokale, të cilat duhen përfshirë në projektet edukative, si në nivelin shkollor, ashtu edhe në atë shoqëror. E përgjegjësia e familjes fillon që kur fëmija është në barkun e nënës, që kur lind.

“Por nënat, baballarët, gjyshërit e familja në përgjithësi, për të luajtur rolin e saj edukativ parësor në kuadrin e ri global, ka nevojë për ndihmë që të kuptojë rëndësinë e kësaj faze fillestare të jetës dhe të jetë e përgatitur për të vepruar”.

Mësuesit, “artizanë” të brezit të ardhshëm

E Papa s'mund të mos përmendte rolin e mësuesve, “artizanë” të vërtetë të brezave të ardhshëm. Me dijen, durimin dhe përkushtimin e tyre, ata u transmetojnë fëmijëve dhe të rinjve një qëndrim, që shndërrohet në pasuri jo materiale dhe formon burrin e gruan e së nesërme.

“Nëse objektivi ynë është t'i ofrojmë çdo njeriu dhe çdo bashkësi një nivel njohurish, të domosdoshme për të krijuar autonominë personale dhe për të bashkëpunuar me të tjerët, është e rëndësishme të kujdesemi për formimin e edukatorëve me standartet më të larta cilësore, në të gjitha nivelet akademike”.

Së fundi, Ati i Shenjtë i lavdëroi pjesëmarrësit e seminarit “Edukimi: pakti global” – akademikë nga universitetet më të mira të botës – për të gjitha studimet e diskutimet mbi përdorimin e metodave e të teknologjive të reja për mësimdhënien; mbi përfshirjen e fëmijëve, që aktualisht nuk kanë shumë mundësi arsimimi, në botën e edukimit; mbi edukimin e refugjatëve dhe të emigrantëve; mbi luftën kundër pabarazive; mbi mjetet për t'u bërë ballë pasojave që ndryshimi i klimës ka edhe mbi arsimimin; mbi mënyrat për të forcuar bazat e një shoqërie më njerëzore, më të shëndoshë, më të drejtë e më të lumtur. Duke i inkurajuar në këtë udhë, Papa përfundoi me fjalët: “Nuk është punë për nesër, por për sot!”



Don Nosh GJOLAJ

Podgoricë

NDIKIMI SOCIAL SI DHE TERAPIA GRUPALE

(Pjesa e tretë)

1. Shoqëria e cila i bie mohut dashurisë!

Njeriu i sotëm është i preokupuar me problemin e vetmisë. Shtrohet pyetja se si ti ndihmojnë njeriut të dalin nga vetmia, frika, ankthi, tmerri nga vdekja, depresioni etj.. Njeriu i sotëm vdes vetëm, si mashkulli ashtu edhe femra, edhe pse dëshirojmë ta përfetojmë vdekjen së bashku dhe ti ndihmojmë njëri tjetrit. Shoqëria e vërtetë është ajo, që i ndihmon njeriut për të dalë nga vetmia si dhe nga vdekja psikike. Dashuria e sinqertë është ajo gëlqerja, që i lidhë burrin dhe gruan në mes vetes, në cilën vatrë krijohet familja e shëndoshë si edhe shoqëria.

Dikur dashuria është shprehur nëpër mes baladës, letra dashurie, poezie, pastaj nëpër telefon, apo nëpër librave romantikë, aty ku lindë dielli i dashurisë. Si dhe takimet nëpër çajtores. Kjo ishte dikur realitet i ëmbël por i dashurisë që ka vdekur.

Nocioni i dashurisë, që është shtylla e një realitetit si dhe thellësia e ndjenjave që i përshkon, është lidhur me gjërat, që ndërlidhen në një mënyrë me përjetshmen, besnikërinë, flinë, vuajtjen, dhurimin e jetës.. Ndoshta ka qenë vetëm vërteta e pastër dhe dashuria nuk ka qenë gjithëherë e tillë, por realiteti ishte ashtu. Ai i cili nuk ka dashuruar dhe ka dashur të jetë i dashuar prej dikujt tjetër, ishte dashuria si e tillë e përjetshme, e paharrueshme. Në të cilën botë mbretëronin princat në kalin e bardh apo heronjtë shpëtimtar, si edhe nga ana e grave, i princesha e mrekullueshme, ky parim vlente si dhe për djem ashtu edhe për vajzat gjatë adoleshencës. Por me vitet dashurinë e preokupojmë shumë gjëra tjera. Dashuria bëhet vuajtje dhe arrite koha kur humben vlerat e kaluarës antike. Zbehet ajo arritje të kultit hyjnzimit të dashurisë spontane, që sjellë një kthesë rrënjësore në raporte mes partnerëve. Kurse sot në botën e internetit, posaçërisht në botën virtuale janë përmbysur të gjitha vlerat dhe cilësitë e një dashurisë romantike, dhe mbretëron fatkeqësisht dashuria si mall konsumues pa ndonjë vlerë të veçantë.

Gjatë historisë e qytetërimit perëndimor ishin jo vetëm dashuria romantike por ishte po ashtu edhe dashuria e shfrenuar. Të dashurosh ishte diçka e bukur, e thjeshtë dhe e lehtë. Dashuria pa

pengesa, e ëmbël por me frymën e vuajtjeve, shoqëria e pranonte me një sinqeritet të gjerë. Ashtu ishin pikëpamjet ndaj dashurisë e cila ishte e përjetshme.

Madje ndërron pikëpamja e saj. Fillohet të flitet, se dashuria nuk është e përjetshme dhe as nuk bënë të jetë. Shoqëria fillon të flasë haptas çfilit kundra dashurisë përjetshme. Bile edhe, tallet në sinqeritetin dhe në besnikërinë e martesës. Sot flitet edhe për drejtat e martesave një gjinore, mos të flasim për mediat që është një faktor i fort që ndikon në zhvillimin dhe në pjekurinë e njeriut të sotëm, i cili ik përgjegjësisë, veçanti të dashurisë, bile as nuk dëshiron ta krijojë familjen, por rrinë beqar, kuptohet bashkëjeton me ndonjë person tjetër. Kuptohet, se kjo dukuri është moda e ditës ose politika e ditore, që krijojnë atmosferën në të cilët e përfetojnë tjetërsimin, nuk gjinden më, përjetimet e tyre janë në kundërtënie me pikëpamjet ose mendësinë filmave të holivudit. Nganjëherë njeriu turpërohet nga dashuria ose me qenë i dashuruar. Mjedisi, në të cilin partnerët jetojnë raportet e sinqerta njëri ndaj tjetrit e rikthejnë dashurinë në iluzion, xheloz, pangopur seksualisht dhe, për këtë individ e lufton të mos të dashurohet. Dashuria e ka domethënien e një lojës me zjarr, kushdo është dashuruar i ka përjetuar ndjenjat e thella emocionale, por disa i kthejnë këto ndjenja në iluzionin. Për këtë shumica nuk kanë hyrë në aventurën, janë shmangë kontratës së fortë të martesës si dhe emocioneve. Në vend ta ngushëllojnë njëri tjetrin si dhe ta ndihmojnë njëri tjetrin në pjekjen e dashurisë u tjetërsohet dashuria dhe mbesin në iluzionin e mendësisë së sotme.

Megjithatë njeri ka nevojë për dashuri, dhe nuk është për t'u habitur pse njeriu i sotëm kërkon zëvendësimin e dashurisë me mallrat konsumuese, që e tjetërsojnë jo vetëm kulturën por edhe qytetërimin si në mendësi ashtu edhe në jetë. Fjala është për zëvendësim, që nuk kanë asnjë farë rrënjë në jetën e përditshme, përpos dashurisë jepmerr, që nuk është asgjë tjetër përveç malli konsumues që e shpjet shoqëria e sotme, që nuk i kursen as nevojat e brendshme të njeriut. Për këtë e kemi festën e Shën Valentinit, pajtorin e të dashuruarve, sepse njeriu kërkon simbolet e dashurisë edhe atëherë kur diçka i mungon. Shoqëria e sotëm e përjashton dashurinë burimore



sepse ajo merret me biznes, me gjërat periferike, dhe e harron çka është bërthama dhe e pranon dhunën seksuale, pornografinë, abuzimet seksuale dhe nga ana tjetër i shmanget dashurisë të mirëfillte.

Pa dashuri

Inteligjenca pa Dashurinë, na bën të këqinjë.

Drejtësia pa Dashurinë, na bën të pamëshirshëm.

Diplomacia pa Dashurinë, na bën hipokrit.

Suksesi pa Dashurinë, na bën arrogantë.

Pasuria pa Dashurinë, na bën koprracë.

Bukuria pa Dashurinë, na bën qesharakë.

Autoriteti pa Dashurinë, na bën tiran.

Puna pa Dashurinë, na bën skllëvër.

Ligji pa Dashurinë, na bën të nënshtruar.

Politika pa Dashurinë, krijon vetëm egoistë.

Feja pa Dashurinë, krijon vetëm fanatikë.

Kryqi pa Dashurinë, është torture.

2. Mos harro në kohë!

Të jesh i dashuruar si dhe të dashurosh është si për mashkullin ashtu edhe për femrën. Nga rrjedhin e përvojat e thella që i lidhin njërin me tjetrin si dhe kontribuon në mënyrën e jetës në tërësi. Ashtu i ndërron si njërin ashtu edhe tjetrën palë. Ndërrimi apo kthesa bëhet pothuaj 180 shkallë si në mënyrë në e jetës ashtu edhe në përshtatjen e mjedisit të ri, kuptohet në gjirin e martesë. Fjala është për përvojat e shumë të ndjeshme, që individit arrin vetëm atëherë kur është i gatshëm për ta jetuar plotësinë e jetës, në dysh me tjetrin. Bashkimi mes personave nuk është vetëm “shkëndija që e ndezë

zjarrin”, por edhe përgjegjësia e madhe si nga burri ashtu edhe nga gruaja. Përvojat e tilla emocionale janë zakonisht vetëm në fillimin e dashurisë, por dashuria duhet t’i tejkalojnë ato. Çifti duhet të jetë i aftë ta pranojë ose ta refuzojë tjetrin, ndjenjat e reja duhet t’i pastrojnë, t’i drejtojnë kah pjekuria dhe plotësia si dhe duhet të dhurohet individit tjetër falas dhe pa kusht, kuptohet duke mos humbur identitetin e vet.

Dashuria fillon në bashkimin drejtpërdrejt dhe realizohet në vazhdimësinë e saj gjatë tërë jetës. Orvatja, që kërkon e përfshirë njeriun në tërësi në të gjitha lëmit e jetës së tij, edhe këtë bile pakusht. Po qe se dashurinë e kufizojmë dhe vendosim për një dashuri disa-ditësh, ose për një vit, ose vetëm për një moment të shkurtër si provë e dashurisë, deri sa të zgjasin bukuria dhe rinia, atëherë në kuptimin e fjalës, jemi skllëvër me idetë mashtruese si dhe dashuria e tillë nuk është asgjë tjetër përveç një shëmtim ose çoroditje.. Mundshme është se dashuria përfundon për një kohë të shkurtër, por kjo nuk bënë të jetë askurrë dhe askush për ta sprovuar a jemi për martesë apo jo, në këtë rast veprojmë kundra vetvetes dhe dashurisë.

Vetë përvojat kërkojnë, se dashuria duhet ta mposhtin kohën dhe të vazhdojnë jetën përgjithmonë, që të mbesin e përjetshme. Ndërsa koha është armiku i përherëshëm i dashurisë, i përjetshmërisë si dhe ja jep vullën përfundimtare.

Mund të themi se dashuria, e cila sot zbehet, pa shikuar të ardhmen, ose të nesërmen, nuk është e drejtë, sepse dashuria është mbi kohore, realitet i dhurimit të plotë tjetrit, që nuk i bëjmë kushte,

sepse dashuria nuk duron tutele. Ai, i cili dashuron, shpeshherë këto gjëra as nuk i di, si dhe përgjegjësia e tij është e cektë, nganjëherë edhe e thellë, është i vetëdijshëm se dashuria kërkon përjetimin instiktiv, se dashuria në momente është e mbërthyer në kohë dhe njëherë e hapur mbi kohore, (e përjetshme).

Individi duhet të ballafaqohet me realitetin e dobësisë si dhe të shpresojë, por gjithherë larg nga romantika. Në radhë të parë duhet të shkundet nga ndjenjat fatalizmit (e shkruar prej Zotit), që e ndërlidhë ndjenjat e dashurisë si një enigmë ose fshehtësi, që sot është e nesër nuk është. Diçka e ngjashme është edhe me vuajtje, që shpërthejnë nga brendia, bile nganjëherë pa ndonjë faj dhe papritmas, por lejnë pas vetes vetëm shkretëtirë, pluhur dhe hi të kaluarës si dhe zëvendëson me dëshirat e vuajtjeve të reja.

Kundra këtij iluzionit, që sot është mjaft i përhapur (vulën që ja jep dashuria romantike), duhet të theksohet, se prirja e dashurisë kah e përjetshmja nuk është iluzion i vuajtjes dhe mashtrim ndjenjave, por nevoja e thellë e brendshme të njeriut, që e ka të njëjtin burim siç është dëshira për t'u takuar me bashkë partnerin. Kush dhurohet sinqerisht është në shërbimin e tjetrit, ai dhurohet gjithherë, në gëzimi si dhe në vështirësi, po ashtu kush e pranon këtë dhuratë, nuk bënë në fillim ta pranojë e pastaj ta refuzojë, por duhet gjithherë i gatshëm për ta kultivuar, me një kujdes të veçantë, sepse është pjesa e tij.

Në një mënyrë mund të themi ky nocion është dashuria magjike. Kjo dashuri ka në vete diçka të fshehur, por përhershshmja e saj është përgjigja në dashuri dhe në besnikëri që nuk ka diçka të fshehur. Personi është ai, që është i rëndësishëm dhe tenton kah mundësia e plotë e besnikërisë. I njëjti person është i gatshëm të flijohet për dashurinë, për këtë edhe e mbron me të gjitha fuqitë e veta. Nga hiçi nuk ka asgjë, ashtu edhe dashuria nuk mund pa "pse", por mbi të gjitha pa aftësia e njërës apo tjetrës palë, për ta pranuar logjikën e thellë të dhurimit, që është e domosdoshme për t'u dhuruar vetveten si dhuratë në pyetjen e "psehit".

Ja një shembull që e paraqet problematiken e sotme të çiftit martesor,

Çadra (ombrella) e kuqe

Gjoni ishte një student i vyeshëm, i ndërgjegjshëm dhe gjatë kohës së studimeve dashurohet me Mriken e cila po ashtu ishte një studente e mirë si edhe e ndershme dhe e bukur.

Gjoni i duhet të shkoi ushtar pas diplomimit. Të dashurës së vetë dëshiron t'i lënë një kujtim, çka do ta përkujtonte në dashurinë e tyre. Kuptohet i duhet ta këqyrë xhepin, për dhuratë e çmueshme nuk ka të holla. Shkon prej në shitore në tjetrën, si ato të mëdha po ashtu edhe shitoret e vogël. Në fund vendosi ta blejë një ombrellë (çadër) me ngjyrë të kuqe.

Nën këtë çadër të dashuruarit betohen dhe i premtojnë se do të duan njëri tjetrin për tërë jetën, dhe pas kthimit prej ushtrie premtojnë njeri tjetrit besnikërinë si edhe do të martohen.

Gjoni pas u kthye prej ushtrie, gjen banesën dhe martohet me Mriken të dashurën e vetë. Çadra përfundon me rrobe e vjetra nën pullazin e shtëpisë. Vitet kalojnë. U lindin dy fëmijë të mrekullueshëm. Pason kujdeset e përbashkëta, kundërshtimet, tendosje, shamatat, ngritje zërit, nganjëherë mërzitja, po ashtu edhe heshtja e teprime që nuk flasin njëri me tjetrin.

Një prej netëve Gjoni e merr gjumi para televizorit. Atëherë Mrika papritmas ngritët në këmbë dhe me nxitim hip në tavan dhe kthehet me çadrën e kuqe. E hapi ku shkundet pluhuri si një mjegull e mbuloi dhomën e pritjes. Gjoni dhe Mrika qëndrojnë nën çadre e kuqe. Zgati për do kohë, ku i rikujtojnë kujtimet e çadrës dhe domethënien për jetën e përbashkët. Përqafohen në mënyrë të delikates duke e puthur njëri tjetri me një puthje të ngrohtë.

Dhe rishtas rikthehen ëndrrat e humbura nën pluhurin e viteve të shkuara.

Askurrë mos e harroni çadrën e kuqe: dashuria e parë, si edhe premtimet për dashurinë e përjetshme, po ashtu edhe besnikërinë.

Thuhet: Çiftet martesore nuk qeshin më. Sikurse nëpër qytete dhe rrugë, shtëpia e fabrika, në vetura, autobusë e hekurudha, në arka dhe sportele, në dhoma e zyra etj. Duket se: qeshja është larguar, sepse në shtëpitë e njerëzve me dashuri ka vdekur po ashtu edhe gëzimi nga rutina dhe dinamika e përditshme, dhe ashtu çiftet martesore përkatësisht familjet kanë vdekur nga të ftohtit e brendshëm!

Mos u bëj fytyrë e vrenjtur! Mos ec me hundë të fryrë! Shkarkoje thasët e mbushura! Ec nëpër shtëpi dhe rrugë i qeshur. Zbulojë dhe hiqja pluhurin çadrës së kuqe. Një fjalë e ëmbël me një buzëqeshje e shkrin akullin e brendshëm e largon rutine si dhe shkund pluhurin dhe ashtu çiftet martesori (familjet) i çliron duke rikthyer jetës, përgjegjësisë dhe dashurisë, besnikërisë së përjetshme.

JEAN-PIERRE SONNET S.I

SECILI ÇIFT ËSHTË NJË « KOPSHT » NJË PERSPEKTIVË BIBLIKE

Bibla na prezanton me një kopsht, një kopsht të lulëzuar nga Zoti, kopsht i quajtur Eden dhe përfundon me evokimin e një qyteti-kopsht, Jeruzalemin hyjnor : « Në mes, në pjacën e qytetit, ku një anë e tij laget nga një lumë, gjendet një pemë e jetës, e cila sjell frute gjatë 12 muajve të vitit, duke sjellë çdo muaj nga një frut ; gjethet e pemës

në lavdinë e saj : “Shpirti dhe gruaja e sapomartuar thonë « Eja ! ». Por Bibla në bën t’i dëgjojmë zërat e ndërthurur të të dashurës dhe dashurit dhe në qendër të trupit të tij, ku shfaqet Kantika, lexojmë : « Sa e bukur je, e dashura ime ! » ; « Sa i bukur je, i dashuri im ! ». Në faqet që vijojnë dëshirojmë që të reflektojmë mbi këtë dyshe në perspektivë, që lidh



shërbejnë për të shëruar shtetet » (Ap 22,2). Edhe nga ana e saj, Bibla na fton në një kopsht, në Kantikën e Kantikave. Qendra e kësaj çështjeje duhet të theksohet, është ajo e sekuencës së librave të traditës katolike, duke e marrë nga versionin grek i viteve '70. Në qendrën e librit të librave të organizuar kështu, në librin e vogël, ku Akiva ka thënë që « Shenjti i Shenjtëve » të Shkrimeve të shenjta është një kopsht me ujë që rrjedh, i mbushur plot me pemë e lule. Fenomeni i sapo përshkruar përsëritet për shkak të çifteve njerëzore. Bibla rrëfen , në faqet e para, shfaqjen e çiftit njerëzor dhe në rreshtat e fundit na bën që ta dëgjojmë thirrjen e gruas ndaj burrit, nga Kisha apo Krishti që shfaqen

“misterin” e kopshtit me atë të çiftit njerëzor. Pse çifti lë një takim në kopsht? Ashtu siç tregohet, në mënyrë fenomenale, lidhja e çiftit është e kësaj natyre njerëzore? Në cilën mënyrë figura antropologjike e kozmike në kopsht na sjell një të vërtetë teologjike? Kantika e Kantikave do të formojë “ambientin” e një reflektimi të tillë; është në faqet e saj ku fton të dashuruarit për të shkuar në kopsht është e shprehur në mënyrë më të thjeshtë: “Le të vijë i dashuri im në kopshtin e tij... Kam ardhur në kopshtin tim, motra ime, gruaja ime”. Paralelisht eksplorimeve të teksteve biblike, do të bëhet fjalë edhe për të hetuar lidhjet që na bashkojnë, ashtu si ndodh përmes një rrjete rrënjësh

të përbashkëta. apa Françesku na sjell 2 tekste didaktike. Letrat shkruajnë : “I bekuar qoftë. Për mbrojtjen e shtëpisë së përbashkët (2015) dhe nxitjes së traditës apostolike. Amoris laetitia. Për dashurinë në familje (2016). Çifti i cili konsiderohet në këtë tekst të dytë, merret në fillim si një sfond apo perspektivë, si një shprehje të vizatimit hyjnor.

Sot e përgjithmonë, kopshti

Në Gjenezë, çifti njerëzor shfaqet në një kopsht, të lulëzuar nga Zoti, por i është lënë njeriut që të kujdeset për të. Ky kopsht, në hebraishte i quajtur “gan”, është një zonë, (rrënja e fjalës do të thotë të mbrosh, të izolosh) e ujitur nga katër kurse uji, ku shtohen qeniet e kujdesshme: “Zoti Jezus bën që të dalin në terren pemët, aq të pëlqyera nga syri dhe të shijshme për t’u ushqyer; si dhe pema e jetës, e cila ndodhet në mesin e kopshtit; edhe pema e ndërgjegjes, e së mirës dhe së keqes.” Në këtë mikrokozmos krijues, burri dhe gruaja njohin njëri-tjetrin.

Nëse çifti largohet nga ky kopsht, pasi nuk i është bindur urdhrat hyjnor, kopshti nuk ik për këtë arsye nga prospektivi biblik; ai do të shfaqet vazhdimisht në imagjinatën e poetëve dhe profetëve biblik. Metafora e kopshtit shfaqet kështu tek Is 61, 11, kur ka të bëjë me shpalljen te populli në zi, sigurinë e ndërhyrjes hyjnore nga ana e tij: “Sepse, ashtu si toka prodhon farën e saj dhe ashtu si një kopsht bën të lulëzojë farën e tij, kështu edhe Zoti Jezus do të bëjë që të lulëzojë drejtësia dhe lavdia përballë të gjithë njerëzve. Kjo metaforë është më e çmuara mes të gjithë të tjerave dhe shërben për të dalluar transformimin që Izraeli do të jetojë në vazhdim, pas ndërhyrjes hyjnore: “Do të jesh si një kopsht i ujitur dhe si një burim ku uji nuk thahet.” Në Ger 31, 12 i njëjti imazh është i lidhur me një rikthim të vendeve të shkretuara. Imazhet e kujdesshme, në fakt, nuk kanë të njëjtat cilësi për të dhënë domethënien e thellësisë ontologjike të shërimit hyjnor. “Do të jem si një vesë për Izraelin e lulëzuar si një zambak. Ai do të ketë bukurinë e ullinjve dhe brishtësinë e Libanit.” Metafora e kopshtit, duke u lidhur me metafora të tjera të kujdesshme, nënvizojnë kështu vizionin biblik, duke demonstruar që bota dhe historia e tij janë gjithmonë “fillesat”, në një mënyrë të pavarur nga plagët e veta të përsëritura. Zoti është ai i cili tërheq në këtë zanafillë, në shërimin që dhuron: ai është një “vesë”, principi misterioz i jetës së kujdesshme. Nga një pikëvështrim tjetër të mençur ndaj teksteve profetike, edhe Kantika tregon: cildo që të jetë mërgimi nga kopshti i parë, ky vazhdon që të mbështesë Biblën. Kantika kujton veçanërisht që

kopshti vazhdon të jetë dhe do të jetë gjithmonë, vendi i shfaqur i çiftit njerëzor. Jo për t’ju përsëritur zgjedhjen e palumtur të bërë nga çifti i zanafillës, por për të jetuar ndryshe, fillime të reja dhe besnikëri të reja.

Kopshti i metaforës

Në Kantikë kopshti është i pranishëm para së gjithash në formën e një metafore. Kjo është sigurisht e pasur me një sfond, në të cilin lexuesi nuk mund ta imagjinojë: atë të kopshteve mesdhetare të Izraelit antik. Po “realiteti” i kopshtit të Kantikës, si fillim është letrar, i pandashëm nga diskutimi i të dashuruarve. Si Robert Alter ka vënë re në shkrimin e tij “Arti i poezisë biblike”, Kantika në Bibël ka një strategji unike në llojin e metaforës, që e dallon nga të gjithë librat e tjerë (përfshirë librin e Giobbe, që karakterizohet për metaforën e tij të krijuar. Metaforat e përfshira të të dashuruarit e Kantikës kanë efektin e “të ngatërruarit të kufijve”. Ashtu si në romanin e Lewis Carroll, personazhet kalojnë “përmes pasqyrës” dhe i gjejnë në botën e metaforës. Metaforat u hapin kështu protagonistëve të Kantikës, një botë të përcaktueshme, që kërkon sjellje të përvetësuar.

Ky është rasti i metaforave të marra borxh nga bota e kujdesshme. “Si një mollë mes pemëve të pyllit/ ashtu duket i dashuri im mes të rinjve/ nën hijen e dëshirueshme të tij ulem/ është i ëmbël fryti i tij për shijen time”. Për të dashurin nuk mjafton ta shikosh të dashurën vetëm si një mollë, duhet të shohim ecurinë, të ulemi në hijen e tij dhe të hamë frytin e dashurisë. Nga ana tjetër, në dy vargjet e mëposhtme, e dashura do të ankohet: “Me mbushni me frymë, më mbushni me molla”. Pak më tej, i dashuri do t’i thotë së dashurës: “Je shtat hedhur si një palmë/ do të ngrij kujtimet e tua”. Nuk mjafton të krahasojmë figurën e së dashurës me atë të palmës: duhet të hipim mbi pemë e të mbledhim frutat. E gjithë parajsa e diskutimit poetik të Kantikës është aty, në këtë mënyrë ta lëmë veten që të tërhiqemi prej lojës së metaforave, duke kujtuar dredhinë”. (“Rruga e saj krahasohet me një palmë”). Një metaforë mund të ketë një sekuencë të gjatë në Kantikë. Kështu, metafora e kopshtit zhvillohet në kapituj nga 4 në 6, në mënyrë që gruaja e re bëhet vetë një kopsht: duhet të shikojmë nga ana e saj e të mendojmë si do të sillet në raport me një kopsht të mbushur me fruta të shëndetshme. Ai përgjigjet: “Një kopsht i mbyllur ti je/ motra ime, bashkëshortja ime”. Ajo ia kthen: “Unë jam një burim që përshkon kopshtet... Le të vijë i dashuri im në kopshtin e tij/ e të ushqehet me fruta të shkëlqyeshme”. Ai: “Kam ardhur në kopshtin tim, motra ime, bashkëshortja

ime”. Ajo: “I dashuri im ka zbritur në kopshtin e tij/ në mes të shtretërve balskamikë të luleve”. Perfeksioni i metaforave të kopshtit njihet se sa është në të njëjtën kohë një shfaqje e gruas së dashuruar (“Ti je një kopsht”) dhe si është një hartë për veprimet e të dashurit, duke i sugjeruar sjellje të përvetësuar. (të vijë, të zbresë, të ushqehet). Mes kapitujve 4 dhe 6, të dashuruarit e Kantikës zhvillojnë kështu lojën e metaforës, deri në pikën që të bëhen ato vërtetë një kopsht, në pritje drejt së ardhmes.

Kopshti, e brendshmja dhe e jashtmj

Në Kantikë fjala “kopsht” shfaqet në buzët e të dashurit edhe për të shprehur intimitetin sekret të së dashurës: “Kopsht i mbyllur ti je,/ motra ime, bashkëshortja ime,/ rrjedhje e mbyllur, burim i mbyllur”. (4, 12). Nëse kopshti është një gardh, atëherë kopshti i mbyllur me çelës, që mbron një burim sekret, është gardhi i gardheve. Konteksti bën që të hamendësojmë tërheqjen fizike mes dy të dashuruarve. Pasuria e diskutimit poetik, konsiston në të njohurit edhe të intimitetit personal. Në pjesën më të brendshme të së dashurës rrjedh një mister (një burim), që përbën të bukurën. Duhet që të vëzhgojmë: është i dashuri ai që zhvillon këtë gjuhë, duke deklaruar të padhunueshme shenjtërinë, që është gruaja që dashuron. Me këtë ai bëhet poeti, pra mbrojtësi-, falë metaforës të kopshtit: në këtë rast, nga “kopshti i mbyllur”, në “dhomat” e tij më të fshehta, ku lundron një ujë diskret dhe i gjallë. Përgjigjja e të dashurit është mahnitëse. Nëse merr imazhet e diskutimit të të dashurit, futet një dinamizëm i papritur. Përtej mureve të tij dhe vetmisë së tij, kopshti është edhe një vend i hapur, për ta cituar nga Rob Aben e Saskia de Wit, a rom with no ceiling (një dhomë pa tavan). Erërat mesdhetare dhe veriore që kalojnë duke ardhur nga gjetiu, të futur si një frymëmarrje e thellë; ujërat janë aktuale e gjëmuese: “Unë jam një burim që ujit kopshtet/ pus që mban ujërat e gjallë/ që rrjedhin nga Libani./ Ngrehu, erë eja/ eja erë mesdhetare,/ fryj në kopshtin tim/ shpërnda aromat tuaja”. (4, 15-16). Edhe një herë, konteksti sugjeron një interpretim shpirtëror të diskutimit që buron nga shpirti. I dashuri do të përgjigjet: “Kam ardhur në kopshtin tim, motra ime, bashkëshortja ime”. (5.1) N a t y r a poetike e diskutimit të gruas, megjithatë bën të mundur që ne të kuptojmë, përveç sqarimeve që dhamë, një evokim të karakterit personal: nëse është një “kopsht i mbyllur”, gruaja nuk do të thotë se është e ndrydhur në vetvete, por frymon edhe në ambient të hapur. Kjo gjë i ndodh kujtdo. Edhe një herë, është kopshti ai që lejon të thuhet më mirë

gjërat. Nëse është një vend i mbyllur, është edhe një vend i hapur; i hapur ndaj qiellit që ndryshon, ndaj elementeve atmosferike, ndaj rrymave të ujërave që e përshkojnë. Në aspektet e veta kontradiktore, kopshti i ofron kështu të dashuruarve, nga një mister personal që mbizotëronte përpara-i qenësishëm në hapjen e qenies kur hyn në një lidhje.

Frutat e pjekura

Përgjatë Kantikës, kopshti është vendi i një mrekullie, që kërkon vëmendjen e të dashuruarve: “Do të shohim nëse lulëzojnë jetët/ nëse petalet mbyllen/ nëse lulëzojnë shegët/ aty do të të fal dashurinë time!” (7, 13). Tre herë bëhet fjalë për spektaklin e lulëzimit të pranverës, të dashuruarit kanë lënë një takim në mrekullinë e lulëzimit. Një bashkëjetesë është në bazë të kësaj tërheqjeje. Një bashkëjetesë vjen si rezultat i kësaj tërheqjeje: në lulëzimin e pemëve të kopshtit ato njohin lulëzimin e dashurisë së tyre: një lulëzim i tillë ndodh në një mënyrë të natyrshme dhe në mbledhjen e njerëzve të tyre. Botanika moderne do të rimarrë diskutimin e të dashuruarve, duke stabilizuar natyrën e luleve, mes pistilit dhe thekrës, intuita e të dashuruarve është për ta e mjaftueshme, e pamposhtur në një lloj kuptimi. Përballë vreshtave apo shegëve të lulëzuara, intimiteti i çiftit zbulohet në bashkimin me të tërë krijimin: kjo e fundit, nga ana e tij, celebron zbërthimin e dashurisë. Kopshti pranveror ofron kështu ogurin e fillimit, në të cilën mrekullohen të dashuruarit: hiri i pazezistueshëm i gonxheve, është ai i lidhjes dhe përf forcimit të dashurisë së tyre.

Kopshti i të dashuruarve nuk është i ndërtuar vetëm nga fara: ka edhe fruta të pjekura mirë (1,3; 4, 13.16; 7,9.14) dhe pemë të rritura (6,11; 7,8-9; 8.5). Nëse dashuria është në fillim, edhe mund të jetë në dorë të fatit qëndrueshmëria, kur i reziston kohës, kohës dhe premtimeve. Ja pse kopshti bëhet shumë familjar. Filozofit Robert Harrison i pëlqen që të thotë që kopshtet janë vende që ngadalësojnë kohën: rritjet kanë hapa të lehta: ai i maturimit të frutave, i rritjes së pemëve. Kopshti mbështet kështu, me qëndrueshmërinë e tij të gjatë, premtimet dhe betimet me të cilat jetojnë të dashuruarit. Siç vëren një personazh i romanit të Richard Powers, nëse të dashuruarit shkruajnë emrat e tyre mbi trungjet e pemëve të mëdha, është pasi njohin në mënyrë konfuze kohëzgjatjen e këtyre shoqëruesve të heshtura: “Mbase kërkojmë që të lëndojmë në këtë mënyrë pemët, pasi jetojnë në një kohë më të gjatë sesa ne.” Në versionin e tij mistik, poeti Rumi (1207-73), ka, kështu të themi, ruajtje trungun, kur ka shkruar: “Dashuria është një pemë, në të cilën degët arrijnë përjetësinë dhe rrënjët rriten në

pafundësi, e për këtë arsye trangu nuk është në asnjë anë!” Çfarëdo që t'i ndodhë trangu, betimet e të dashuruarve të Kantikës shartohen në pemët, të cilat i rrethojnë (fiqtë, lajthitë, arrat), duke i marrë hua diçka të jetëgjatësisë së tyre.

Ky mister është i madh

Për të prezantuar variacione të dukshme kulturore, simboli i kopshtit kalon të gjithë historinë: është një qenie universale njerëzore. Megjithatë, ai është i gjallë vetëm në ekzistencën e kopshteve. Sa më shumë që të jenë të rrezikuara ekuilibrat antropologjikë dhe mjedisorë, aq më të shumta do jenë sfidat sociale, rrjedhimisht aq më shumë duhet të jenë të mbjella pemë në kopshte. Në romanin e tij të shkurtë, “Njeriu që mbillte pemë”, Jean Giorno na tregon historinë e një pastori, Bouffier, i cili bën që të rijetohet i gjithë rajoni i tij, në shoqërinë e lartë, thjesht duke mbjellë, me një kokëfortësi delikate. Pastori provincial ka gjetur një imitues nordamerikan në romanin e Richard Powers “The Overstory”: Douglas Pavlicek, që në këngën e tij mbjell 50 000 pemë “Douglas blu” për të vënë në kontrast shpyllëzimin dhe pylltarinë intensive në Kaliforni. Të hysh në një kopsht, të ulesh dhe të hysh në një vend ku mund të rilindësh për së dyti, aty ku njeriu mund të mendojë, pasi ky vend është i afërt për të. Volteri na thoshte që duhet të kultivojmë kopshtin tonë, duke nënkuptuar se kishte ardhur koha për të përmirësuar kushtet njerëzore, duke i lënë mënjane spekulimet. Secili duhet ta rishohë frazën e Volterit dhe ta marrë fjalë për fjalë, duke krijuar kështu kopshte (kopshte perimesh, kopshte me bimë mjekësore, botanike, vertikale, urbane, të humbura në natyrë, të heshtjes dhe meditimesh). Kopshti është një utopi. Siç vëren Michel Foucault: “Kopshti është grimca më e vogël e botës, e nga ana tjetër është qendra e botës. Që nga Antikiteti kopshti është një lloj heterotopie e lumtur dhe universale. Por këto heterotopi janë kontestime mistike dhe reale të hapësirës në të cilën ne jetojmë. Të dizenojmë, të mbledhim, të rrisim një kopsht do të thotë të projektosh në të ardhmen e në kohë një takim të vetvetes sonë, në rinjohje. Një takim i tillë do të jetë gjithnjë, takimi i çifteve dhe i të dashuruarve. “Eja në kopsht, Maud!”-është thirrja që i drejtohet të dashurës së Tennyson, ku ai thotë duke menduar për të: “Mund të ecja gjithnjë në kopshtin tim”. Raporti që lidh kopshtin dhe çiftin e Kantikës së Kantikave, ka marrë një traditë të mahnitshme kristiane nga Vangelo Di Giovanni. Në skenën e paraqitjes në Gcv 20, Krishti i ringjallur dhe Maria Madalenë, marrin borxh rolet përkatëse të dashuruarve të Kantikës. Elementi më antropologjik -përballja e të dashuruarve në

kopshtin e shenjtë- tregohet nga evangjeli. Skena e Gv 20, ka si kontekst një kopsht, atë të varrit të Jezusit: “Tani në vendin ku ishte kryqëzuar, ishte një kopsht dhe në kopsht një varr i ri, në të cilin askush nuk ishte vendosur. Aty pra do të pushonte Jezusi” (Gv 19,41-42). Është drejt këtij kopshti që Maria Madalenë shpejton që të shkojë ditës së parë të javës “në mëngjes, kur ishte akoma errësirë” (Gv 20,1).

Takimi i Jezusit me Maria Madalenën dramatizohet falë skenarit të marrë borxh nga Katika. Mbase kjo është një dëshmi antike e lidhjes së Kantikës së Kantikave me festën Pesah, që zhvillohej në judizëm. Pas referimit në Kantikë, fshihet edhe një dëshmi e kopshtit të origjinës. Është në një kopsht që njeriu ka humbur lidhjen me botën dhe këtë rrugë do ta gjejë pikërisht në një kopsht. Por, gjëja që na bie më së shumti në sy është skena e Pashkëve të kopshtit, e cila krijon një dialog mes burrit dhe gruas. Vepra e Zotit, ringjallja e Jezu Krishteit- bën përmbushjen e misionit të tij, kur merr simbolizmin antropologjik të fjalës së shkëmbyer mes burrit dhe gruas, në gardhin e kopshtit.

Që të mbjellësh një kopsht do të thotë t'i ofrosh besimtarëve një parabolë të gjallë të besnikërisë ndaj Zotit, në dizenjimin e tij shpëtimtar, mes kopshtit të origjinës dhe atij të ringjalljes, në pritje të qytet-kopshtit, që është Jeruzalemi hyjnor. Përgjatë shekujve, kopshti i Kantikës është bërë, për interpretimin e krishterë, takimi mes Zotit dhe njeriut në martesat mistike, por edhe në mishërimin e Fjalës. Pra Jezusi ka zbritur në kopshtin e tij, -shkruan Apponio, monark italian i shekullit V,- duke u zhveshur nga fuqia hyjnore, përmes së cilës i është bashkuar Atit. Ai mund ta mirëpresë brishtësinë njerëzore, përmes së cilës i është bashkuar njeriut, duke u bërë ndërmjetës mes njëri-tjetrit. Duhet theksuar që gjithçka bën, e bën për kopshtin e tij dhe për këtë popull që njihte, ku patriarkët dhe profetët ishin lodhur pafundësisht për ta ndërtuar. Të lulëzosh një kopsht do të thotë të ngjallësh çiftin dhe kopshtin. Mes burrit dhe gruas, kopshti është “Shenjtë i Shenjtëve”i mbledhjes, parabola e fillimeve të mrekullueshme e të rritjeve të ndershme, të intimitetit sekret e të bashkësisë me të gjithë krijimin së bashku me Krijuesin. “Ky mister është i madh”,-thotë Paolo në lidhje me martesën njerëzore dhe të Eukaristisë (Ef 5, 32). I njëjtë është edhe misteri që lidh çiftin me kopshtin.

Përktheu: Bernardina Shahini
Material i përkthyer nga revista
kulturore–fetare
“La civiltà cattolica”, 2020.

CCEE/COMECE

SISTEMI I BAZUAR NË IDEOLOGJINË E NACIONALSOCIALIZMIT - SHKELEJ DINJITETI I NJERIUT

*Deklaratë e Presidencës së Këshillit të Konferencave Ipeshkvore të Evropës
(CCEE) dhe e presidentit të komisionit të konferencave ipeshkvore të bashkimit Evropian
(COMECE) në 75-vjetorin e çlirimit të kampit nazist gjerman të shfarosjes të Auschwitz-Birkenau*



Kanë kaluar 75 vjet nga çlirimi i kampit nazist gjerman të përqendrimit dhe shfarosjes të Auschwitz-Birkenau (27.01.1945), dhe ky vend ende shkakton tmerr.

1. Auschwitz-Birkenau është kampi më i madh nazist i përqendrimit dhe i shfarosjes, i hapur në 1940 në territoret e pushtuara polake. I destinuar fillimisht për polakët (Auschwitz), është zgjeruar ndjeshëm në zonën e afërt të Brzezinka-s (Auschwitz-Birkenau) dhe në vitet 1942-1945, në kuadër të programit të “zgjidhjes përfundimtare” (Endlösung), u bë vend i shfarosjes në masë të popullsisë hebraike. Në Auschwitz-Birkenau, nacionalsocialistët gjermanë vranë më se një milion hebrenj, dhjetëra-mijëra polakë (rreth 75.000), romë (21.000), rusë (15.000) dhe disa mijëra robër të kombësive të tjera. Për shkak të numrit tejet të madh të viktimave hebrenje, ky është kampi më i madh i shfarosjes së hebrenjve dhe vendi më i madh në botë i genocidit në masë.

Auschwitz-i është bërë simboli i të gjitha kampeve gjermane të përqendrimit si dhe i të gjitha vendeve të shfarosjes. Është si kulmi i urrejtjes për njeriun, që e ka paguar haraçin e vet të vdekjes në shekullin XX. Pikërisht këtu teza mbi pabarazinë themelore të personave e ka arritur kufirin e vet. Këtu nazistët morën në dorë pushtetin për të vendosur se

kush ishte njerëzor dhe kush jo. Këtu eutanazia takoi eugenetikën. Auschwitz-Birkenau është rezultati i një sistemi të bazuar në ideologjinë e nacionalsocializmit, që donte të thoshte të shkelej dinjitetin e njeriut si shëmbëlltë e Hyjit. Edhe një tjetër totalitarizëm, komunizmi, ka vepruar në të njëjtën mënyrë dhe ka shkaktuar miliona viktima.

2. Ish-kampi i përqendrimit i Auschwitz-Birkenau vizitohet çdo vit nga qindra, mijëra persona. Mes vizitorëve kanë qenë edhe tre papët e fundit.

Shën Gjon Pali II e vizitoi Auschwitz-Birkenau-n gjatë shtegimit të tij të parë në Poloni (7 qershor 1979). Pasi Papa Gjon Palli II-të kaloi kangjellën e kampit me shkrimin që mban sipër “Arbeit macht frei”, vizitoi qelinë e vdekjes së Shën Maksimilian Maria Kolbesë dhe u lut në oborrin e Bllokut 11, ku u pushkatuan robërit. Pastaj shkoi në Birkenau, ku kremtoi Meshën e Shenjtë dhe gjatë homelisë u shpreh: “Në veçanti po ndalem së bashku me ju, të dashur pjesëmarrës në këtë takim, para lapidarit me shkrimin në gjuhën hebraike. Ky shkrim nxit kujtimin e Popullit, bijtë e bijat e të cilit ishin të destinuar për shfarosjen e plotë. Ky Popull e ka zanafillën e vet prej Abrahamit, që është ati i fesë sonë (krh. Rom 4,12), siç është shprehur Pali i Tarsit. Pikërisht ky popull, që ka marrë prej Hyjit urdhërimin: ‘mos vra’, ka provuar mbi vete në masë të veçantë se çfarë do të thotë të vrasësh.

Kurrë nuk është e lejueshme për një komb ta rrisë pushtetin e vet në kurriz të një kombi tjetër, me çmimin e nënshtrimit të tjetrit, me çmimin e pushtimit, të shkeljes, të shfrytëzimit dhe të vdekjes!”.

Papa Benedikti XVI e kapërceu vetëm kangjellën e kampit (28 maj 2006) dhe gjatë ceremonisë pranë Monumentit ndërkombëtar të Martirizimit të Kombeve, mbajti një fjalim në të cilin deklaroi: “Sikurse Gjon Pali II, përshkova rrugën përgjatë lapidarëve, që në gjuhë të ndryshme, kujtojnë viktimat e këtij vendi. Ka një të tillë në gjuhë hebraike. Sundimtarët e Reich-ut të Tretë donin ta shtypnin popullin hebre në tërësinë e tij; ta zhduknin prej listës së popujve të tokës. ... Në fund, ata kriminelë të dhunshëm, me asgjësimin e këtij populli, synonin të vrisnin atë Hyj që thirri Abrahamin, që duke folur në Sinai vendosi kriteret orientuese të njerëzimit, që mbeten të vlefshme për amshim. ... Me shkatërrimin e Izraelit, me Shoah-un, donin, në fund të fundit, të shkulnin edhe rrënjën në të cilën bazohet feja e krishterë, duke e zëvendësuar atë përfundimisht me fenë e bërë vetë, fenë e sundimit të njeriut, të të fortit. ... Po, pas këtyre lapidarëve fshihet fati i qenieve të panumërta njerëzore. Ata e shkundin kujtesën tonë, e shkundin zemrën tonë. Nuk duan të ngjallin në ne urrejtjen: madje na tregojnë se sa e tmerrshme është vepra e urrejtjes”.

Gjatë vizitës së tij në ish kampin e përqendrimit të Auschwitz-Birkenau-t (29 korrik 2016), Papa Françesku ndoqi gjurmët e dy paraardhësve të tij. Nuk mbajti asnjë fjalim, por prania e tij e heshtur qe shumë shprehëse. Në librin përkujtues shkroi: “O Zot, ki mëshirë për popullin tënd! O Zot, po të kërkojmë falje për kaq shumë mizori”. E përfundoi vizitën e vet me një lutje te Monumenti i Martirizimit të Kombeve.

3. Disa ditë më parë, Papa Françesku ka bërë një thirrje: “Përvjetori i mizorisë së patregueshme që njerëzimi zbuloi shtatëdhjetë e pesë vjet më parë le të jetë një thirrje për t'u ndalur, për të qëndruar në heshtje e për të kujtuar. Na shërben për të mos u bërë mospërfillës” (Fjalimi drejtuar delegacionit të “Simon Wiesenthal Center”, 20 janar 2020).

75-vjetori i çlirimit të kampit të përqendrimit të Auschwitz-Birkenau-t, nëpërmjet fjalëve të Papa Françeskut, na detyron t'u kundërshtojmë me forcë të gjitha akteve që kërcënojnë dinjitetin njerëzor: racizmit, ksenofobisë dhe antisemitizmit. Në këtë përvjetor i bëjmë thirrje botës moderne për pajtimin dhe paqen, për respektimin e së drejtës së çdo kombi për të ekzistuar dhe për të jetuar në liri, për ta parë të njohur pavarësinë e vet, për të ruajtur kulturën e vet. Nuk mund të lejojmë që e vërteta të shpërfillet apo të manipulohet për nevoja politike të momentit. Kjo thirrje është tejet e rëndësishme tani, sepse –

pavarësisht prej përvojave dramatike të së kaluarës – bota në të cilën jetojmë është ende subjekt i kërcënimeve të reja dhe i shfaqjeve të dhunës. Luftëra mizore, raste të genocidit, përndjekje, dhe forma të ndryshme fanatizmi vazhdojnë të ndodhin, edhe pse historia na mëson se dhuna nuk çon kurrë në paqe, por, përkundrazi, shkakton dhunë tjetër dhe vdekje.

4. Duhet të kujtojmë se, edhe pse pas Luftës së Dytë Botërore pajtimi mes kombeve dukej i pamundur nga ana njerëzore, të bashkuar në dashurinë e Jezu Krishtit, kemi qenë të aftë të falim dhe të kërkojmë falje. E tregon këtë letra e vitit 1965 e ipeshkvinjve polakë drejtuar ipeshkvinjve gjermanë. Përvoja e së kaluarës na mëson se sa e rëndësishme dhe e frytshme është të ndërtojmë një Evropë kombesh të pajtuara dhe që e falin njëri-tjetrin.

Më 27 janar në orën 15.00, në orën e çlirimit të kampit të përqendrimit të Auschwitz-Birkenau-t, le të ndezim një qiri dhe të lutemi për personat e vrarë në kampet e përqendrimit të të gjitha kombësive e besimeve dhe për të afërmit e tyre. Lutja jonë e rritë pajtimin dhe vëllazërinë, e kundërta e të cilëve janë armiqësia, konfliktet shkatërrimtare dhe keqkuptimet e ushqyera. Forca e dashurisë së Jezu Krishtit sundoftë mbi ne.

Autori në “Çeta e profetëve” ka gjetur mundësi të shtjerë elemente të jetës shqiptare të kohës e të historisë së popullit tonë, si është rasti i qëndresës burrërore të kelmendasve kundër ekspeditës turke më 1639. Mendimet e njohuritë e ipeshkvi shqiptar imzot Pjetër Bogdanit shpalosen më shkoqur në parathënie e librit dhe në relacionet e shumta, që hartoi pas vizitave apostolike e baritore në viset e dioqezave që ai drejtoi si bari shpirtëror.

Vetëm vetëdija dhe besimi i thellë në forcën e gjuhës shqipe, e shpuzi në flakërimën e atdhetar këtë intelektual dhe patriot të madh, e hovi të shkruajë një vepër kaq të madhe siç ishte dhe mbeti përgjithmonë emblemë, “Çeta e Profetëve”. Në personalitetin e mëtuar sakaq duhet parë gjeniun në punën e vet. Ai shkriu dijen e kohës së përparuar, artin e vuri në mbrojtjen e idealeve dhe pikmapjeve iluministe, duke ia kushtuar gjithçka dhe çdo gjë kombit.

Shkroi me dashuri të madhe për gjuhën shqipe, për Atdheun e për popullin shqiptar, shprehu dhembje për gjendjen e mjeruar e padijen në të cilat i kishte hedhur robëria bashkatdhetarët e tij dhe kundërshtim të thellë për pushtuesin osman. Imzot Pjetër Bogdani kërkonte që t'i jepeshin popullit shqiptar libra në gjuhën amtare, punoi për mëkëmbjen dhe zhvillimin e kulturës kombëtare dhe çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj.

Pjetër Bogdani do të mbetet në memorin e personaliteteve shqiptare edhe si poliglot, këndshikim që rreket të përplotësojë si të tërë këtë manifestim të

gjeniut të iluminimit. Duke cekur në lëmin diturak të tij numërojmë gjuhët të cilat ai ka njohur, fillojmë me italisht, latinisht, greqisht, serbokroatisht, turqisht, hebraisht, arabisht, armenisht dhe sanskritisht. Hamendje gjithashtu se ai zotëronte frëngjisht dhe gjermanisht. Është kjo galeri e thellë prejnga burojnë diejt e fuqishëm dritëdhënës të vullnesës së mirë krijuese, kulomtuese dhe kushtruese.

Prej vlerave të shumta shencore dhe artstiko-letrare të veprës së Pjetër Bogdani dallohet trajtimi dhe vendosja e drejtë e çështjeve etnopsikologjike dhe historike, pasuria e madhe gjuhësore në shtjellimin e lëndës në prozën shkencore, humanizmi i lartë në

Bogdani letërsia dhe gjuha letrare shqipe shënuan hapa të rëndësishëm përpara.

Vepra ka në krye një seri kushtimesh e poezish shqip, latinisht, italisht, sllavisht, shkruar për nder të Pjetër Bogdani nga miq e të njohur të tij. Dy vjershat shqipe të Luca Bogdanit e të L. Sumës dhe ato të vetë autorit të shpërndara në kapituj të ndryshëm të librit, me teknikën poetike përgjithësisht të sigurt janë tregues të lëvrimin të mbarë të vjershërimit shqip në këtë kohë.

Pjetër Bogdani krijoi me vetëdije të plotë për ta pasuruar e përpunuar gjuhën shqipe, gjurmoi dhe vuri në qarkullim fjalë e shprehje të vjetra të lëna në harresë, krijoi edhe fjalë të reja, duke bërë përpjekjet e para për krijimin e termave në ndonjë degë të shkencës. Ligjërimit i tij dallohet mjaft herë edhe për zhdërvjelltësi e ndërtime sintaksore të një arkitektonie të sigurt. Me veprat e Pjetër Bogdani letërsia dhe gjuha letrare shqipe shënuan hapa të rëndësishëm përpara.

Për veprën e Pjetër Bogdanit kanë shkruar studiues e shkrimtarë të njohur shqiptarë e të huaj si Gaetano Petrotta, Eqrem Çabej, Faik Konica, Filip Fishta, Alberto Straticò, Mario Roques, Justin

Rrota, Matteo Sciambra, Injac Zamputti, Idriz Ajeti, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti etj. Prej këtej Pjetër Bogdani ishte dhe do të mbetet në thelb devocion i një atdhetari të shëlbyer, shërbestari dhe kryemjeshtri të interesave të shenjta për të cilat ai dha kaq shumë, aq sa një mirënjohje është më së paku ajo që i detyrohem.

Kardinal Angelo BAGNASCO
President i CCEE

Kardinal Jean-Claude HOLLERICH
President i COMECE

Kardinal Vincent NICHOLS
Zëvendëspresident i CCEE

Arqipeshkëv Stanisław GADECKI
Zëvendëspresident i CCEE

Gjenova, Bruksel, Londër, Varshavë,
më 25 janar 2020



paraqitjen e realitetit të kohës, filozofia, intelektin i rrallë letrar, etj.

Ai hapi shtigje dinjitoze kah vlerat evropiane, çka shihet në idenë për lëvizjen ballkanike, për liri kombëtare dhe shpirtërore.

“Arti i të shkruarit dhe ligjërimit që mishërohet në vepër si tregues i nivelit të kulturës dhe zhvillimit intelektual të tij dhe angazhimi dinjitoz si prijës dhe tribun popullor e ngriti lart veprën e tij madhore, të lindur në gurrat e një humanizmi të thellë, duke i treguar popullit rrugën e zhvillimit të lirë e të pavarur, andej kah bota e përparuar.”, sendërgjon një krijues çka Bogdani mëton me jetën dhe veprën.

Imzot Pjetër Bogdani krijoi me vetëdije të plotë për ta pasuruar e përpunuar gjuhën shqip dhe popullin shqiptar me të vërtetat e fesë së krishterë e, gjurmoi dhe vuri në qarkullim fjalë e shprehje të vjetra të lëna në harresë, krijoi edhe fjalë të reja, duke bërë përpjekjet e para për krijimin e termave në ndonjë degë të shkencës si dhe në teologjik e në fjalorin kishtar në përgjithësi. Ligjërimit i tij dallohet mjaft herë edhe për zhdërvjelltësi e ndërtime sintaksore të një arkitektonie të sigurt. Me veprat e imzot Pjetër

JEMI NE ATA QË E DËGJOJMË FJALËN E ZOTIT

Java e Lutjes për Bashkimin e të Krishterëve

Fundi i muajit janar shënon për kishën katolike Javën e Lutjes për Bashkimin e të Krishterëve. Më 20 janar 2020 në orën 18.00, në kishën e Shën Françeskut në Shkodër, u organizua lutja e mbrëmësore e udhëhequr nga Imzot Angelo Massafra, O.F.M., Arqipeshkëv Metropolit i Dioqezës Shkodër – Pult. Pas leximit të Ungjillit të parashikuar nga liturgjia e ditës, Arqipeshkvi bëri homelinë, gjatë së cilës theksoi se jemi ne ata që e dëgjojmë fjalën e Zotit. Ashtu siç e thotë Isaia profet “sikurse shiu bie nga qielli dhe atje nuk kthehet pa dhënë fryt” kështu as fjala e Zotit nuk do të shkojë kot, por do të realizohet”- përfundime këto fjalë homelinë Imzot Angelo Massafra.

Në këtë lutje të mbrëmësore ishte i pranishëm Atë Nikolla Petani, famullitari i kishës ortodokse “Lindja e Krishtit” këtu në Shkodër, i cili, pas homelisë së Arqipeshkvit, drejtoi një fjalë nxitëse besimtarëve për të qenë misionarë të fjalës së Zotit. Në fjalën e tij ai i fton besimtarët të dalim nga mjediset tona për të shkuar drejt atyre që kanë nevojë për Fjalën e Zotit.

Ndërsa më datën 22.01.2018, në orën 18.00, në Kishën ortodokse “Lindja e Krishtit” Shkodër, u organizua lutja për bashkimin e të krishterëve, e udhëhequr nga Atë Nikolla Petani së bashku me Atë Ivan Popaj, meshtarë ortodoks i shuguruar me 24 nëntor 2019.

Atë Nikolla, gjatë homelisë së tij, tha se ne nuk bëjmë mjaftueshëm atë ç'ka thotë Zoti në Ungjill, sepse Ungjilli i ditës së sotme na tregon se Jezusi i urdhëroi Apostujve që t'i japin njerëzve të hanë, pra kjo është detyra jonë, që t'ua shpallim të gjithëve Fjalën e Zotit, që është ushqimi i



shpirtit tonë. Duhet të lusim Zotin që t'i shndrisë mendjen udhëheqësve tanë që të largojmë mëkatin shumëvjeçar të mos marrjes së kungimit së bashku, që një ditë të mbërrijmë të kremtojmë së bashku meshën dhe të marrim kungimin e njëjtë. Në këtë mbrëmësore ishte i pranishëm Imzot Angelo Massafra, O.F.M., Arqipeshkëv Metropolit i Dioqezës Shkodër – Pult, i cili, pas homelisë së Atë Nikolla Petanit, komentoi ungjillin e ditës duke nxitur besimtarët në lutje për bashkimin e kishave.

Nga ana e Zyrës së Ekumenizmit janë përgatitur, shtypur dhe shpërndarë në kisha të ndryshme të qytetit të Shkodrës, por edhe në famulli të tjera, postera, ku lajmërohej rreth këtij aktivitetit, me të gjitha informacionet e nevojshme.

Ndërsa ju është shpërndarë të gjithë të pranishmëve në kishat përkatëse të lartpërmendura broshura me lutjen e mbrëmësore dhe me disa lutje të tjera që pasurojnë liturgjinë, për një lutje sa më të mirë me tema të përgatitura nga kisha të ndryshme nëpër botë, që bëjnë përvojën e ekumenizmit së bashku. Për këtë vit java e lutjes për bashkimin e të krishterëve ishte përgatitur nga kishat e krishtera që janë të pranishme në Maltë.

Kjo javë është përgatitur nga Zyra e Ekumenizmit të Arkidioqezës Shkodër – Pult, duke i dërguar të gjithë meshtarëve, rregulltarëve e rregulltareve materialin me E-mail, e përgatitur me lexime biblike, të cilat mund të zëvendësojnë ato të ditës përkatëse, së bashku me lutje të tjera dhe lutjen e mbrëmësore që do të lutej në kishën tonë të Shën Françeskan në Shkodër.

Atë Landi Jaku OFM



EVALDA PACI

PROFILI PREJ SHQIPËRUESI I ATË BENEDIKT DEMËS

Ai paraqitet në përmasat e një trajtese mjaft të gjerë e serioze, me synime të qarta nga përfrimi me përmbajtjen e Biblës, me kulturat e hershme jo domosdoshmërisht i.e., me antikitetin, por edhe me historinë e religjioneve.

Figura dhe emri i Atë Benedikt Demës O.F.M. lidhen pazgjidhshmërisht me kontribute që priren nga historia e shtypit françeskan, leksikografia shqipe, por edhe nga historiku i botimeve mbi mësimin e parimeve themelore të besimit të krishterë dhe praktikës liturgjike në gjuhën tonë. Perspektiva e mësimin të fesë dhe të besimit katolik në shkollat shqiptare në gjysmën e parë të shekullit të kaluar konkretizohet, ndër të tjera, në një botim disavëllimësh për përpilimin dhe shqipërimin e të cilit u angazhua në veçanti Atë Benedikt Dema.

Mësimi i përgjithët i besimit (Apologjëtika) që botohet në Shkodër nga Shtypshkroja “A. Gjergj Fishta” në vitin 1943, mbështetet në një model të shkruar në gjuhë të huaj e të hartuar prej dr. A. König, docent i Universitetit të Breslaui. Ai paraqitet në përmasat e një trajtese mjaft të gjerë e serioze, me synime të qarta nga përfrimi me përmbajtjen e Biblës, me kulturat e hershme jo domosdoshmërisht i.e., me antikitetin, por edhe me historinë e religjioneve. Veçanërisht, referimi ndaj Besëlidhjes së Vjetër përkon plotësisht me një prirje të qartë ndaj zbërthimit të teksteve të saj në një dritë që sqaron më së miri elemente të Besëlidhjes së Re, sidomos pjesëve që lidhen drejtpërdrejt me shfaqjen konkrete të Mesisë në Ungjijtë. Në këtë pikëpamje nënvizohet qartë qëllimi teozofik dhe teologjik i të shkruarit të kësaj vepre dhe caktimit të saj për një auditor liceal e shkollor.

Puna e shqipëruarit Dema ofron një panoramë të gjerë hulumtimi sa i takon besnikërisë së sjelljes së mjaft elementeve leksikore e konceptuale në këtë fushë, por edhe përrurimit të mjeteve të gjuhës sonë në realizimin e një përshtatjeje aspak të thjeshtë, aq më tepër nëse destinatari konkret do të jetë student i liceut të naltë klasik e real.

Pa dyshim, kurrikulat shkollore të atëhershme shfaqen të pasuruara në pikëpamje përmbajtësore mjaft të arsyetuara nëse u referohemi edhe botimeve të tjera, përfshirë këtu shqipërimi gramatikash latine (Sintaksa dhe vëllime ushtrimesh të plota); histori qytetërimi të hershëm greko-romak, një pjesë e mirë e të cilave gjithashtu kanë parë dritën e shtypit në tipografinë Atë Gjergj Fishta. Mund të vërejmë në këto vëllime kaq të rëndësishme gërshetimin e



dimensioneve që mëtojnë nga didaktika e metodologjia, rikthimin e vëmendjes nga disiplina themelore, si historia e antikitetit, filozofia antike e ajo mesjetare, shkencat e natyrës që qenë objekt vëmendjeje edhe në veprat e mesjetës së vonë dhe që e bëjnë mjaft interesante dhe objekt qasjesh të ndryshme veprën e shqipëruar nga Atë Benedikt Dema O.F.M.

Historia e Kishës së Romës, në veçanti periudha e problematika e Konkilit tridentin, gjejnë pasqyrim e shpjegim të zgjeruar në vise të veçanta të këtij shqipërimi, që ka të bëjë me mësimin e besimit katolik, për të vijuar më tej me vlerën që paraqesin përkthimet e Ungjijve në gjuhët përkatëse amtare, me një referim konkret edhe ndaj teksteve të disponueshme në atë kohë në gjuhën tonë e që lidhen me emra të spikatur të historisë së shqipërimin të tekstit biblik.

Bleni me titull Mësimi i veçantë i besimit (Shkodër, 1944), i treti në radhën e serisë përkatëse, por i dyti si pasues i botimit të vëllimit të parë të saj në gjuhën shqipe, përbën një zgjerim dhe zbërthim të

natyrshëm të mjaft koncepteve të cekura në vëllimin e parë të sipërcituar.

Duket ky i fundit më i thjeshtuar në pikëpamje të trajtimit të nënndarjeve tematike që kanë të bëjnë me vetë besimin katolik, por edhe në këtë pjesë të veprës kujdesi ndaj terminologjisë përkatëse dhe përfshirja e argumenteve sa filozofike aq edhe teologjike përbëjnë prirje të qarta e konsekuente në shtjellimin e përmbajtjes së saj.

Në paragrafë të caktuar të këtij vëllimi vihet re qartë se përmbajtja nuk shkëputet prej një misticiteti që buron nga vetë shpjegimet që kërkojnë, pa dyshim, referime etimologjike dhe historike, por nga ana tjetër kjo përmbajtje shfaqet më konkrete dhe më e lehtë për t'u ndjekur në pikëpamje të shkallës së vështirësisë së brendësisë së tekstit.

Është e mundur, pa dyshim, të gjurmojmë përdorime që kujtojnë autorë paraardhës që ndërmorën sprovë të shqipërimit të teksteve të caktuara nën synimin që të ishin funksionale në raste shërbesash liturgjike, por edhe të vëmë në dukje modele formimi dhe ndërtim që marrin domethënie pikërisht nën veshjen që i jep në këtë vepër shqipëruesi ynë, Atë Benedikt Dema. Pavarësisht natyrës së veprave që Atë Benedikt Dema ndërmerr të shqipërojë në këto vite, gjithsecila bëhet pasqyrë e një formimi specifik dhe të admirueshëm në fushë të terminologjisë së liturgjisë, por edhe e reflektimit të përdorimit të një sërë modelesh formimi që cekin e përfshijnë disa kategori semantike, njëkohësisht edhe klasa të caktuara fjalësh. Në çdo vështrim që synon të nënvizojë kontributet e Atë Benedikt Demës në këtë lamije hulumtimi e pune këmbëngulëse, duhet theksuar me bindje se ky formim pasqyrohet edhe në ruajtjen e natyrës së trajtesës dhe në përshtatjen me një nomenklaturë që bën të mundur të jetë edhe më e zgjeruar fusha e emërimit të nocioneve të caktuara.

Përdorime të caktuara bëjnë të nënvizosh bindjen se ndërtimet që në njëfarë mënyre u promovuan në veprat e letërsisë së vjetër shqipe, gjejnë një vijimësi të natyrshme në këto shqipërime. Kësisoj, të tilla botime, që bëhen edhe më të vyera me kalimin e viteve dhe janë përfaqësuese të sprovave për të plotësuar një panoramë të shqipërimit të punimeve në fushë të liturgjisë, por edhe pjesëve nga Ungjijtë apo patrologjia kryesisht latine që domosdoshmërisht përfshihen si elemente tekstore ilustruese në përmbajtjen e tyre, bëhen dëshmi e eficientësisë së zgjidhjeve të ofruara kohë më parë nga autorë paraardhës.

Nga një vështrim i hollësishëm i përftesave që bëhen objekt përdorimi në këto shqipërime, mund të nënvizohet prirja për terma sa më të përshtatur, ndër

të cilët veçojmë hyjnderim, parafolje, parathanje, parandjesi, parakënë, por edhe shpjegime në shqipe që u pranëvihen termave dogmatikë në gjuhën latine.

Në rastet e shqyrtuara, Atë Benedikt Demës mund t'i atribuojmë pa ngurrim merita autorësie për vetë zgjidhjet jo thjesht leksikore që ofron ndaj një regesti terminologjik aspak të thjeshtë për çdo gjuhë, jo vetëm për shqipen. Në pikëpamje të modeleve të formimit, gjejmë me vend të veçojmë një sërë ndërtimesh që në kuptimin kategorial, por edhe fjalëformues, janë emërzime trajtash me origjinë ndajfoljore, emra veprimi, emra prejfoljorë të tipit kena e gjëja, por gjithashtu edhe fjalë plaka (të moçme) që plotësojnë hijshëm tekstet e këtyre shqipërimeve. Nuk lëmë dot pa përmendur pranëvënien përdorimesh, si Këna e njisija e Hyjit; Natyra e vetit e Hyjit; Njinija e Trinija e Hyjit, të rëndësishme si në pikëpamje të vendit që zënë në përbërje të veprës së Artur König, ashtu edhe po aq të rëndësishme në pikëpamje të nëntekstit që realizohet nëpërmjet këtyre përdorimeve të pranëvëna.

Dema ka njohur dhe ka vënë në përdorim, pa dyshim, shkrimet e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe, por siç duket edhe nga shënimet me të cilat plotëson brendinë e shqipërimit të mësimi të besimit katolik në liceun e naltë, ai ka njohur dhe konsultuar shqipërimet e varianteve ungjillore të Atë Xanonit e të Dom Lekë Bitrojt, pse jo edhe të Kristoforidhit, të cilat edhe i citon duke i diferencuar konkretisht në disa pasazhe të punimeve në fjalë. Plotësimi i nomenklaturës së konceptit të Krijuesit, por dhe të krijimit në dritën e historisë së fesë e të filozofisë me plottribute e ndajshime, duhen konsideruar vlerë e aftësisë së shqipëruesit për të bërë tekstin sa më të afrueshëm dhe të qartë e të saktë me lexuesin e tij. Ndërtim si fe, besim e religjion gjinden në paragrafë të caktuar të këtyre shqipërimeve, duke qenë fjalë kyçe që shënojnë pika të rëndësishme në të cilat është ndalur si autori, ashtu edhe vetë shqipëruesi si përshtatës i tekstit në fjalë: Besimi i ynë do të jët i fortë e i qindrueshëm, d.m.th. na nuk do të dyshojm vullëndetisht për kurrnji të vërtetë fetare e do të jemi gati, qi më parë të bierrim gjithshkohen, t'apim edhe jeten vetë, se t'i biejm mohit fës. (Martyrët shëjten.) Besimi i ynë do të jët i plotë d.m.th. na do të besojm pa perjashtim të gjitha të vërtetat e zbëlueme; do të jët edhe i gjall, d.m.th. do të jetojm si na mëson besimi, prandej do t'i largohemi së keqes e do të bajm vepra të mira. Nji kësi besimi është vepra më e randsishmja e nderimit të Zotit e nji dhantë e bukur, qi mendja e nierit bân para gjithdijes e vertetësis së Hyjit.

Duhet vënë në dukje se veçanërisht në përbërje të këtyre vëllimeve të konsultuara të Mësimi të besimit katolik gjinden jo pak fragmente nga Ungjijtë dhe

nga Besëlidhja e Vjetër. Duke qenë destinuar të jenë elemente ilustruese në përmbajtje të një punimi shpjegues e shtjellues të mjaft prirjeve që kanë të bëjnë me njerëzoren dhe përballjen e saj me hyjnoren, mistikën dhe thelbin e besimit të Zotit, reflektimin e besimit në jetën e individit, këto elemente tekstore në më të shumtën e rasteve paraqiten koncize dhe jo fort të gjata.

Është po aq e qartë se në botimet që Atë Benedikt Dema, asokohe profesor në Lyceun "Illyricum" të Shkodrës, përzgjedh të shqipërojë dhe t'ia ofrojë një auditori kryesisht intelektual dhe që zotëron një kulturë fetare, gjurmohen natyrshëm pasazhe dhe elemente introductive që të kujtojnë si ligjëratat e plota në pikëpamje tematike në veprën e Bogdanit, ashtu edhe pjesë të tjera nga doracakët kateketikë që në gjuhën shqipe panë dritën e botimit dhe të ribotimit, duke na ofruar edhe variante të njëpasnjëshme të Besojmës, gjithashtu edhe të lutjeve të tjera themelore në liturgjinë e përditshme. Veprat që ndërmori të shqipëronte Atë Benedikt Dema O.F.M. mbartin edhe përmasën didaktike që ka të bëjë me një lloj brendësimi përmbajtësor të vetë Biblës, por jo më pak atë ezegjetike dhe pedagogjike. Ngërthimi i natyrshëm, por edhe i arsytuar, i tyre vihet re në secilën prej këtyre sprovave që mbartin përkujdesjen e thelluar prej shqipëruesi nga ana e tij.

Veçanërisht në blenin e dytë për nga radha e botimit të kësaj kolane vihet re nënvizimi i një synimi: shkrija e qartë e dimensionit teologjik me atë doktrinar e kateketik. Nënvizohen të vërtetat e fesë, por edhe të mësuarit e nocioneve dogmatike në proces të katekezës apo praktikës së liturgjisë, sidomos kur përshkruhen detaje të një kulture specifike që ka të bëjë me Meshën shëjte dhe çdo hollësi tjetër që lidhet me zhvillimin e saj, detaje këto që kanë të bëjnë edhe me meshtarin, edhe me besimtarin. Sakraliteti i këtyre elementeve plotësohet nga vetë regjistri gjuhësor i përdorur, që dëshmon njohuritë e thella të shqipëruetit në një sërë fushash, nga të cilat nuk lëmë pa veçuar atë të historisë së kulturave fetare e vijimësisë së tyre të pasqyruar në besimin katolik. Pa dyshim që të tilla shqipërime janë njëkohësisht një burim i rëndësishëm dokumentar për studiues të dialektologjisë shqipe e në veçanti të asaj historike. Një dimension i tillë vihet re në veçanti në botimin Jeta e krishtenë, i cili është konceptuar të shërbejë si një librec këshillësh e mësimesh sidomos për civila intelektualë.

Jeta e krishtenë (librec këshillësh e mësimesh sidomos për civila intelektualë), në dukje një libërth modest në pikëpamje vëllimi, por mjaft interesant në pikëpamje të gjurmimit përmbajtësor, përbën një shtysë të goditur për të përmbushur qasje me variante

paraardhëse doktrinash a doracakësh kateketikë që edhe pse më të përmbledhur falë faktit që kanë pasur objektivin e të përmbajturit në përmasa compendiumesh sintetike, përmbajnë në thelb një nomenklaturë të tërë elementesh e emërtimeve që gjinden gjithashtu edhe në variantin e shqyrtuar të Benedikt Demës. Ky botim i fundit jep shkas gjithashtu për hulumtuar ndaj një prirjeje po aq të veçantë në përkujdesjen ndaj tekstit nga ana e Benedikt Demës, duke qenë se i ofrohet mundësia të introdukojë variante lutjesh themelore të ngulitura në gëgnishten e asaj kohe.

Të shkruarit në një gëgnishte konsekuente dhe skrupuloziteti ndaj një regesti terminologjik kompleks që mbart qartë përpjekjen për të emërtuar saktë e duhur çdo nocion të rëndësishëm të fushës së liturgjisë dhe teologjisë, mbetet një prej tipareve qenësore të këtyre shqipërimeve. Elemente të rëndësishme të një jete mendore që ka të bëjë drejtpërdrejt me praktikën religjioze në vise të caktuara të Shqipërisë (u referohemi dhe përdorimeve si kryqa, rruzare, medaja, kemi, shkandull), mbijetojnë edhe sot e kësaj dite duke shërbyer edhe si relikte të një spektri më të hershëm, por dhe të gjerë, kulturor e mendor.

Vetë veprat që u përpunuan nga Atë Benedikt Dema O.F.M. përfaqësojnë në vetvete modele të veçanta në pikëpamje të ndërthurjes së disa elementeve përmbajtësore që evokojnë, pa dyshim, edhe doracakë kateketikë apo liturgjiarë me përmbajtje dhe lutjesh themelore në fushë të praktikës fetare, dhe vepra me prirje nga ezegjeza dhe didaktika biblike. Qasja e tyre me të tjera vepra analoge që disponojmë falë një tradite të pasur shkrimore të promovuar nga Dom Lekë Bitroj, Atë Jak Junk S.I., Vinçens Prennushi, Donat Kurti, Justin Rrota e prelatë të tjerë bën të mundur shprehjen e mendimit se një periudhë e tillë kohore ka shënuar me anë kontributesh konkrete një tjetër shtysë në ecurinë e shqipërimit dhe përshtatjes së veprave fetare në traditën e besimit katolik. Ato meritojnë vëmendje në pikëpamje të shkallës së lëvrimit të shqipes dhe kontributit në drejtim të promovimit të pasurisë kryesisht leksikore të shqipes. Profili prej shqipërueti i Atë Benedikt Demës O.F.M. shënohet ndjeshëm nga këto kontribute të realizuara në gjysmën e parë të viteve '40 të shekullit të kaluar e që kanë të bëjnë me mësimin e fesë e të besimit, mësimin e moralit dhe historinë e Kishës e të krishterimit. Konkretësia e tyre bën që ato të radhiten si ndihmesa themelore në fushë të shqipërimit dhe të tekstit liturgjik dhe atij biblik, duke qenë i përfshirë ky i fundit në çdonjërin prej veprave që u ndërmorën në këtë trajtesë.

DIALOGU NDIHMON NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË SECILIT!

Paraqitja e mesazhit të Papës për ditën botërore të paqes.

Jam i gëzuar t'ju paraqes dhe t'ju dorëzoj këtë mesazh të Papa Françeskut, shkruar qëllimisht për Ditën Botërore të Paqes, që këtë vit ka për temë: PAQJA SI ECJE SHPRESE: DIALOG, PAJTIM DHE KTHIMEKOLOGJIK.

Faleminderit Luigj Miles me bashkëpunëtorët. Një falënderim shkon për drejtoreshën e teatrit “Migjeni”, zj. Rita Gjeka me punëtorët e teatrit si dhe për ju te pranishëm.

Analiza që Papa na ofron nëpërmjet këtij mesazhi, nuk kufizohet vetëm në vëzhgime me natyrë socio-politike, por krahas tyre ai ofron edhe lidhje të guximshme me Fjalën e Hyjit.

Që në fillim ai na flet për “një vëllazëri reale, të bazuar në origjinën e përbashkët që kemi, domethënë që të gjithë vijmë prej Hyjit, dhe të ushtruar në dialog e besim të ndërsjellë”; një koncept që do ta përpunojë dhe do ta shpjegojë përgjatë gjithë mesazhit.

“Shpresa” është fjala-kyç. “Nuk mund ta arrish paqen, nëse nuk e shpreson atë. Përpara së gjithash duhet të besosh në mundësinë e paqes, të besosh se tjetri ka po aq nevojë sa edhe ne për paqe”.

Pastaj Papa Françesku lartëson vlerën e kujtesës dhe të dëshmitarëve, që sipas tij: “duhen ruajtur jo vetëm për të mos bërë sërisht të njëjtat gabime apo për të mos propozuar të njëjtat skema gënjeshtarë të së kaluarës, por edhe me qëllim që ajo, fryt i përvojës, të jetë rrënja dhe të sugjerojë rrugën për zgjedhje të tanishme dhe të ardhshme paqeje”.

Në dëgjimin e dëshmitarëve mund të vendoset një tjetër element themelor: dialogu, ai “mes burrave e grave që kërkojnë të vërtetën përtej ideologjive dhe opinioneve të ndryshme... Në dëgjimin e ndërsjellë mund të rriten edhe njohja dhe vlerësimi i tjetrit, deri në atë pikë sa te armiku të shohim fytyrën e një vëllai”.

Dialogu ndihmon në mbrojtjen e të drejtave të secilit, sidomos të më të dobëtëve.

Françesku garanton se Kisha katolike ecën në këtë drejtim, në “kërkimin e një rendi të drejtë, duke vazhduar t'i shërbejë të mirës së përbashkët dhe të

ushqejë shpresën e paqes, nëpërmjet përçimit të vlerave të krishtera, mësimi moral dhe veprave shoqërore dhe të edukimit”

Në fund, gjithmonë duke u bazuar te Fjala e Hyjit, na paraqet elementet e fundit karakteristike të këtij Mesazhi: pajtimi dhe kthimi ekologjik.

Pajtimi është shfaqja e gjithë pushtetshmërisë së Hyjit, një qëndrim që duhet ta kemi të gjithë, si individë dhe si popuj: “Vetëm duke zgjedhur rrugën e respektimit mund të shkatërrohet spiralja e



hakmarrjes dhe të ndërmerret ecja e shpresës... Kjo ecje pajtimi na thërret që në thellësinë e zemrës sonë ta gjejmë forcën e faljes dhe aftësinë për t'u pajtuar si vëllezër e motra. Të jetuarit në falje rrit aftësinë tonë për t'u bërë burra e gra të paqes”.

Kthimi ekologjik tregon respekt ndaj Hyjit krijues dhe respekt ndaj krijesave të tij. Prandaj, le t'i themi jo “armiqësisë sonë ndaj të tjerëve, prej mungesës së respektit ndaj shtëpisë sonë të përbashkët dhe shfrytëzimit abuzues të burimeve natyrore – të parë si mjete të dobishme vetëm për një përfitim të sotëm, pa treguar respekt për bashkësitë vendore, për të mirën e përbashkët dhe për natyrën”.

Ju ftoj të gjithëve që ta mirëprisni këtë Mesazh të Papës, ta meditonit dhe ta zbatoni atë me zgjedhje konkrete jete; këtë e bëj duke parafrazuar vetë fjalët e tij: “Besojmë në mundësinë e paqes, besojmë që tjetri ka po aq nevojë sa edhe ne për paqe. Në këtë, mund të na frymëzojë dashuria e Hyjit për secilin prej nesh, dashuri liruese, e pakufizuar, falas dhe e palodhur”.

Vit të mbarë paqeje të gjithëve ju.

**Më 8 janar 2020, në teatrin “Migjeni”
Imzot Angelo Massafra - Arqipeshkëv**

PËR TË ARRITUR PAQEN DUHET TË JETOJMË NË HARMONI

*Dita botërore e paqes
8 janar 2020 në teatrin “Migjeni” Shkodër*

Data 1 janar shënon fillimin e një viti të ri në gjithë botën, por për besimtarët katolikë është një ditë ripërtëritjeje shpirtërore, sepse më 1 janar të çdo viti, duke filluar nga viti 1968 me Papa Palin VI, përcillet mesazhi i Shenjtërisë së Tij drejtuar besimtarëve katolikë në gjithë botën, por edhe atyre të besimeve të tjera.

Viti 2020 përkon me vitin e LIII të kremtimit të Ditës Botërore të Paqes ndërsa në Shqipëri është viti i XXIII i festimit të kësaj dite të rëndësishme, e cila në Shqipëri e ka zanafillën e festimit të saj të parë në vitin 1997.

Kremtimi i Ditës Botërore të Paqes në Shqipëri u iniciua nga fretërit françeskanë ndërsa që nga viti 2003

harmoni me të afërmit, nevojtarët, popujt e tjerë por edhe me natyrën. Problemet e mjedisit janë një temë e prekur dhe e ndjeshme nga Papa Françesku.

“Duhet të vlerësojmë zemërgjerësinë e Krijuesit që na dhuroi tokën”- shprehet Papa. Duke parë gjendjen e rënduar të planetit tonë, për të cilën të gjithë jemi dëshmitarë, kësaj teme iu kushtua më shumë vëmendje. Për këtë arsye, koncerti festiv i përvitshëm, me rastin e Ditës Botërore të Paqes, u hap me një video sensibilizuese që trajtonte problematikat me të cilat po përballlet planeti ynë sot.

Aktiviteti ishte konceptuar si një ndërthurje të mesazhit të Shenjtërisë së tij, Papa Françeskut, me një aktivitet artistik – kulturor me të rinjtë e qytetit të



organizimi dhe vazhdimi i kësaj tradite iu besua Komisionit Drejtësi dhe Paqe të Shqipërisë, i cili, në bashkëpunim me Arqipeshkvinë Shkodër – Pult dhe nën kujdesin e veçantë të Arqipeshkvit, Imzot Angelo Massafra, e ngriti nivelin e saj duke i dhënë rëndësinë e merituar dhe duke e zhvilluar atë në teatrin “Migjeni” të Shkodrës.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin përfaqësues të komuniteteve fetare si: Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult; Ipeshkvi i Sapës Imzot Simon Kulli; At' Nikolla Petani, famullitari i Kishës Autoqefale Ortodokse në Shkodër, personalitete lokale si kryetarja e Bashkisë Shkodër, zj. Voltana Ademi dhe qytetarë të panumërt të Shkodrës.

Mesazhi i Shenjtërisë së tij, Papa Françeskut, për këtë vit ishte: Paqja si ecje shprese: dialog, pajtim dhe kthim ekologjik. Një temë shumë aktuale, e përbërë nga disa nëntema, në thelb të të cilave është gjithmonë paqja, sepse siç thotë Papa: Paqja është një pasuri e çmuar, objekt i shpresës sonë, për të cilën aspirojmë gjithë njerëzimi!

Pikërisht për të arritur paqen duhet të jetojmë në

Shkodrës dhe të famullive përreth.

Dita Botërore e Paqes është një ditë feste, dhe si e tillë u shoqërua me këngë e valle nga të rinjtë. Kjo ditë është njëkohësisht dhe një ditë sensibilizimi për detyrat tona si qenie njerëzorë ndaj njëri – tjetrit, por edhe ndaj natyrës.

Shqipëria, më 26 nëntor të vitit që lamë pas, përjetoj fatkeqësisht një tërmet të fuqishëm, që shkaktoi një tragjedi njerëzore me humbjen e 51 jetëve në disa qytete të Shqipërisë dhe në të gjithë ishëm dëshmitare të forcës së natyrës. Si homazh për këto jetë të ndërprera në mes në këtë aktivitet viktimave të tërmetit iu kushtuan poezi.

Kjo ngjarje duhet të na ndërgjegjësojë dhe të na mësojë të respektojmë më shumë natyrën dhe forcën e saj krijuese, por nganjëherë edhe shkatërrimtare.

Aktiviteti, organizuar me rastin e Ditës Botërore të Paqes në Teatrin “Migjeni” në Shkodër, u mbyll me mesazhin e përfaqësuesve shpirtëror dhe ato të pushtetit lokal, drejtuar të pranishmëve dhe gjithë shqiptarëve në mbarë botën, duke i uruar atyre “VIT TË MBARË!”

Majk Mila

TOMË MRIJAJ

TË MËDHENJTË E KOMBIT

“Me pranue me heshtjen t'onë një cilsi të tillë që nuk i përgjigjet së vërtetës, mue m'asht duke se bajmë krim kundra vetvetes, kundra historis e kundra fmijëve e njerzve tanë, që do të mbeteshin me kryeultë për breza të tanë para shoqnisë... me i lane historishkruesit të së nesërme një dokument që t'a kenë të gjithë shqiptarët për studim.” - Kol Bib Mirakaj

Zanafilla e një shkrimi

Libri, Kolë Bib Mirakaj, *Vetvrasja e Një Kombi*, Florentia, Shkodër, 2014. Me ardhjen time në New York, në fillim të vitit 1978, pas pak muajsh mua dhe bashkëshorten time, na ftoi për një vizitë në shtëpinë e saj Lula, vajza e patriotit të shquar ish Ministrit të Brendshëm të Shqipërisë, atdhetari i pamposhtur antikomunist Kolë Bibë Mirakaj.

Lula me familjen e saj, jetonte në një lagje të qytetit të madh Brooklyn, së bashku me fëmijët: Nikolla, Donika dhe Matilda.

Ne u impresionuam shumë qysh në hyrje të banesës së tyre. Deri në ato ditë, nuk kisha parë asnjëherë një atdhedashuri të madhe, që kjo familje ruante për vendlindjen dhe trojet etnike shqiptare.

Në dhomat e tyre ishte pasqyruar dukshëm Shqipëria në miniaturë. Në muret e dhomës mikpritëse ishin të varura portretet e shumë figurave të shquar të historisë së popullit shqiptar, simbolet kombëtare, lahuta, çiftelia, plisi i bardhë, flamuri kuq e zi pa yllin komunist, librat e shumta në gjuhën shqipe, ku, mbi të gjitha ishin të ekzpozuar kryeveprat e identitetit tonë kombëtar, si: “Lahuta e Malcisë” e shkruar nga poeti kombëtar atë Gjergj Fishtës O.F.M., “Kanuni i Lek Dukagjinit” (Botimi i Parë, i vitit 1933, me parathënie brilante, të shkruar nga patrioti i shquar atë Gjergj Fishtës), hartuar nga intelektuali dhe patrioti i madh i kombit tonë atë Shtjefen Gjeçovi O.F.M. etj., koleksioni i plotë i revistës fetaro kulturore “Jeta Katholike Shqiptare” (1966), themeluar dhe drejtuar nga shkrimtari, studiuesi dhe publicisti i palodhur i komunitetit tonë, meshtari dhe prelati i kishës së parë katolike shqiptare “Zoja e Këshllit t'Mirë” (sot “Zoja e Shkodrës”) në SHBA, i paharruari mons dr. Zef Oroshi (1912-1989) etj.

Mbas një mikpritje bujare tradicionale, zhvilluam një bisedë të ngrohtë dhe miqësore,

duke rrokur tema të ndryshme, ku, më e rëndësishmja ishte ajo për vendlindjen, masakrimet dhe internimet e shumta, që po pësonin njerëzit e pafajshëm nën sundimin e rrëgjimit të egër komunist në Shqipëri, si dhe kalvarin e vuajtjeve dhe internimeve, që kishin pësuar disa nga antarët e familjes Mirakaj, që nuk kishin mundur të arratiseshin nga ferri burg komunist i diktatorit Enver Hoxha.

Në një moment qetësie e pyes Lulën, se a ka lënë diçka të shkruar babai juaj Kola? Ajo menjëherë mu përgjigj në mënyrë pozitive, shkurt dhe prerë, se babai i saj i kishte lënë disa dorëshkrime, të cilat i ruanin si relikte të çmuara, sepse kanë vlera historike.

Lula u ngrit ngadalë nga sofa e shtruar, dhe na u drejtua me fjalët: Ju lutem prisni pak, se po vij shpejt. Ajo hyri në një dhomë të shtëpisë dhe pas disa minutash doli me një libër në dorëshkrim, të cilën na e tregoi, duke thënë, se ky që po shihni tani është një dorëshkrim të cilin babai e ka shkruar me kujdes me makinë shkrimi.

U afrova me kujdes dhe lexova menjëherë titullin e librit të pabotuar, që kishte një titull shumë interesant: “Vetëvrasja e një kombi”.

Unë i kërkoja Lules, që ta hapte pak librin e mbështjellë me kujdes me një mbulesë plasmasi, që të shikoja disa fjalë nga dorëshkrimi, por ajo tha se e kishte amanet nga babai i saj Kolë Bibë Mirakaj, që askush të mos e hapte deri sa libri në dorëshkrim të botohej, pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri...

Dhe ashtu ndodhi! Lula dhe familja e saj e mbajti amanetin e babait të tyre.

Pas disa ditëve, me makinë së bashku me prelatin mons. dr. Zef Oroshin shkuam për të bërë një vizitë miqësore tek shtëpia e Kapidanit të Mirditës juristit Ndue Gjomarku.

Ai mbasi na priti me një buzëqeshje dhe na ftoi që të hyjmë brenda, në bisedë e sipër, ndër të tjera Kapidani më pyeti: “Tomë, a ka ndonji gja të re këto ditë!?”

Unë i thashë se isha për një vizitë pak ditë më parë tek shtëpia e Lulës, vajzës së Kolë Bibë Mirakaj. Aty më bëri përshtypje titulli i një libri në dorëshkrim me titull interesant: “Vetëvrasja e një kombi”.

Kapidani Ndue, më shikoj drejt në sy dhe më tha: “Kol Bib Mirakaj, ka kenë një nacionalist i vendosun e i ka luftue gjithnjë padrejtsitë e kohes

dhe të njerzve.”

Kjo bisedë e re, bëri që edhe meshtari ynë mons. dr. Zef Oroshi, të shpreh mendimet dhe përjetimet e tij për figurën e madhe të Kolë Bibë Mirakajt.

Ndër të tjera dr. Oroshi tha, se: “Kola ka ken një njeri i ditun, njeri i zgjuet e i besës, fjal pak e punë shumë, një pend dhe mendje e mpreht, orator dhe një atdhedashës i zjarrtë. Ai e urrente komunizmin dhe servilat e tij, që shetisnin lirshem si informator në emigracionin e Italisë dhe SHBA-së.”

Në fund të bisedës dhe para se të largohemi nga shtëpia e tij, Kapidani Ndue Gjomarku, më dha si kujtim fletoren apo të përkohshmen: “L'ALBANIE LIBRE”, që dikur ishte organi i Blokut Kombtar Independent.

Ai shtoi se në këtë buletin mund të gjeni shumë informacione, shkrime të Kolë Bibë Mirakajt.

Kolë Bibë Mirakaj dhe Vetëvrasja e një kombi

Kam menduar dhe gjithnjë mendoj, se të mëdhenjtë e kombit, nuk mund të jenë kurrë tradhtarë të kombit, cilitdo qofshin idealet e atyre, kur ata janë konsekuentë dhe të qëndrueshëm në ato ide atdhetare, të cilave ua kushtuan gjithë jetën realizimit të tyre.

Për më tepër, këto ide i udhëheqin si programe

dhe qëllimi i vetëm i jetës së tyre, mbetet gjithnjë e mira e përbashkët e kombit, popullit dhe e prosperitetit të tij.

Këta idealistë përparimtarë, përbëjnë elitën cilësore të kombit dhe mund të quhen me të drejtë personalitete të shquar të kombit tonë.

Në këtë grup njerëzish të mëdhenj të kombit tonë, bën pjesë edhe Kolë Bibë Mirakaj, i cili, me të drejtë asokohe dhe sot, zë një vend nderi të merituar në historinë e lavdishme të kombit shqiptar.

Në të gjithë ngjarjet plot tallaze, me humbje dhe fitore të zhvilluara gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj deri sa ndërroi jetë Kolë Bibë Mirakaj ishte një ndër protagonistet më të mëdhenj të atyre viteve plot ngjarje, që u zhvilluan jo vetëm në vendlindjen tonë gjatë viteve 1939-1944, por edhe jashtë Atdheut deri në emigracionin e largët në Evropë dhe SHBA.

Sikurse të gjithë nacionalistët e shquar pararendës, që bënë emër shumë të madh në trojet shqiptare, ideali i tij kryesor ishte bashkimi i të gjithë forcave politike atdhedashëse në një front të vetëm, kundër rrezikut komunist.

Kjo për faktin e vërtetë historik, se ish Ministri i Brendshëm Kolë Bibë Mirakaj e njihte shumë mirë natyrën e rrëgjimit diktatorial komunist stalinist në Bashkimin Sovjetik (B.S.), ku, gjithnjë të drejtat dhe liritë e njeriut shtypeshin sistematikisht me

gjak dhe hekur, ku, popujt e federatës ruse vriteshin, persekutoheshin, internoheshin, pushkatoheshin, me gjyq fallco dhe pa gjyq, ashtu sikurse edhe qindra vjet më pare, kur shtypeshin dhe keqtrajtoheshin njerëzit në epokën e lashtë të skllavërisë së plotë.

Ai e shihte të pamundur shpëtimin e Shqipërisë nën kthetrat e komunizmit të zi.

Kjo ishte një katastrofë e tmerrshme komuniste, sikurse e quante ai, sepse e njihte shumë mire tragjedinë që do të pësonte në të ardhmen vendi i shqiponjave dhe populli ynë, nën rrëgjimin totalitar ateist komunist.

Ngjarjet, që po zhvilloheshin me shpejtësi në arenën ndërkombëtare, për fat të keq nuk e favorizonin Shqipërinë e mjerë dhe popullin e saj.

Kështu në Konferencën e Jaltës,



Shqipëria ishte lënë padrejtësisht në zonën e influencës komuniste.

Dhe për këtë gjë Kola, falë vizionit që kishte mendonte dhe shpresonte, se vetëm me bashkimin e partive antikomuniste, në një bllok të vetëm do të behej e pamundur ardhja në pushtet e partisë komuniste.

Nëse ne e marrim seriozisht dhe mobilizohemi, për të bërë gjithçka për Atdheun tonë, atëherë mund të vij në pushtet blloku i partive nacionaliste përparimtare, që me programe perëndimore ishin kundër diktaturës komuniste dhe shtypjes së lirive dhe të drejtave të njeriut.

Kola, shpresonte shumë tek partitë dhe organizatat nacionaliste, për një Shqipëri të lirë dhe demokratikë. Këtë mision të rëndësishëm historisë, mund ta realizojnë vetëm: Partia e Legalitetit, Socialdemokratët e Mysine Kokalarit, Partia e Ballit Kombëtar, Blloku Independent, si dhe të gjithë forcat e tjera nacionaliste, që ishin kundër diktaturës dhe shtypjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut, me të cilat populli shqiptar do t'i shpëtonte diktaturës komuniste.

Për fat të keq, Shqipëria kishte rënë viktimë e partisë komuniste, që drejtohej nga një grup njerëzisht aventurier me histori kriminale, ku, qëllimi i vetëm i se cilës ishte lufta e tyre për marrjen e mbajtjen e pushtetit me çdo kusht e mënyrë dhe jo lufta kundër pushuesve të huaj nazi-fashistë asokohe.

Tashmë, është e qartë si drita e diellit, se ideja e këtij bashkimi, sikur të ishte realizuar në atë kohë do të ishte shpëtimi i kombit shqiptar, ide dhe dëshirë, për të cilën Kolë Bibë Mirakaj shkriu gjithë jetën e tij.

Dhe për këtë tragjedi fatkeqe, të mbarë kombit si në Shqipëri dhe Kosovës, Kolë Bibë Mirakaj e drejtoi gishtin me të drejtë në udhëheqësin e Ballit Kombëtar, të cilët e refuzuan këtë bashkim sistematikisht si brenda vendit ashtu dhe në emigracion me pretekstin se nuk pranojnë bashkëpunim me “bashkëpunëtorët” e fashizmit, ndërsa një pjesë e tyre u munduan të mohojnë bashkëpunimin asokohe me gjermanët.

Dihet nga të gjithë, se në Shkodër komanda gjermane e Gestapos dhe komanda e Ballit Kombëtar ndodheshin më pak se 100 metra larg njëra tjetrës. E para ndodhej tek Konsulata Italiane dhe e dyta tek Bashkia e qytetit.

Dihet, gjithashtu se Balli Kombëtar pranoi të bashkëpunonte me Partinë Komuniste armikun më të madh të popullit shqiptar, por këto të fundit se pranuan bashkëpunimin, sepse jugosllavët:

Dushan Mugosha dhe Vladimir Stoiniq donin që pushtetin ta merrte vetëm Partia Komuniste e diktatorit Enver Hoxha.

Komunistët serbo malazezë, që drejtonin de facto Partinë Komuniste të Shqipërisë qysh nga viti 1941, për më tepër nuk donin t'a ndanin pushtetin me asnjë forcë tjetër rivale politike, sepse vetëm me partinë komuniste ata (serbo malazezët), mund ta shtinin në dorë më vonë jo vetëm Kosovën por edhe Shqipërinë, me parrudhën e vëllazërimit: Bashkim - Vllazërim.

Nga sa na mëson nëna histori, mësojmë se Balli Kombëtar u bë kështu përçarësi i forcave politike, në unison me Partinë Komuniste, sepse edhe ata ëndërronin pushtetin e plotë për vete.

Së fundi, brenda Ballit Kombëtar, fatkeqësisht vazhdoi pa ndërprerje procesi i përçarjes së vetë kësaj organizate, duke u ndarë në 5-6 parti të vogla të papërfillshme, që s'vonuan shumë dhe u shkrinë si kripa në ujë.

Ky ishte fundi i pashmangshëm i Ballit Kombëtar, një fund i dështimit të plotë dhe turpshëm, politika e të cilit i kushtoi aq shtrenjtë popullit martir shqiptar.

Në këtë shkrim e vura theksin kryesor vetëm në një aspekt të veprimtarisë së Kolë Bibë Mirakaj: aspektin e luftës për bashkimin kombëtar dhe për shpëtimin nga diktatura komuniste.

E kush luftoi më shumë komunizmin se sa Bloku Independent, që Balli e quante organizatë fashiste kundër komunizmit!?

“Qeta e Shpagimit” dhe “Komiteti i Maleve” e vazhduan luftën deri në vitin 1953, pra 9 vjet pas ardhjes në pushtet të rrëgjimit komunist. Ata e dëshmuan me gjakun dhe jetën e tyre martire urrejtjen ndaj komunizmit si asnjë krahinë tjetër.

Ja pse mosrealizimi i idealit të Bllokut Independent, për bashkim kombëtar në luftë pa kompromis kundër komunistëve (që udhëhiqej nga Gjomarkajt), solli dështimin e këtyre perpjekjeve dhe humbjen e luftës me stalinistët komunistë.

Regjimi komunist u instalua dhe dihet se çfarë pësoi populli shqiptar në atë regjim për afro 50 vjet.

Pra, u arrit ajo që Kolë Bibë Mirakaj i ruhej dhe druhej më shumë: Vetëvrasja e një kombi.

Se fundi, del argumenti, se patrioti i shquar Kolë Bibë Mirakaj, ishte eksponenti kryesor i idealeve të zjarra të bashkimit të kombit shqiptar, pa dallim feje dhe krahine, në luftë frontale, të papajtueshme kundër ideologjisë komuniste, që po shkatërronte trojet e Arbërisë.

Dr.Tonin ÇOBANI

I BUZËQESHNI NJËRI-TJETRIT! ” DHE TRE TREGIME TË VËRTETA (OSE PJESËRISHT TË VËRTETA) NGA JETA E NËNË TEREZA.

Foto Albumi “Nënë Tereza në pullat shqiptare” të Hysen S. Dizdarit (shqip dhe anglisht), AGSTUDIO.al, Tiranë, 2018, 50 ff. me parathënie të Dom Lush Gjergjit.

Duke e uruar autorin për botimin luksoz, më lejon të ndalem shkurtimisht në atë që unë e quaj thelbin e filozofisë së Nënë Terezës “**I buzëqeshni njëri-tjetrit!**” dhe **tre tregime të vërteta** (ose pjesërisht të vërteta) nga jeta e saj, të cilat i kam pasë publikuar edhe më parë.

1. “I buzëqeshni njëri-tjetrit!”

Kudo që veprimi Nënë Tereza ka shpërfaqur me kurajë, qoftë varfërinë tradicionale, qoftë atë të zyrtarizuar. Prandaj vepra e saj “*nuk është punë sociale ose shërbim humanitar*”. Madje Nënë Tereza nuk mund të jetë as thjeshtë një bamirëse e madhe. Ajo “*kurrënnuk ka pasur fonde as për vete as për motrat e saj*”, shkrua Don Lush Gjergji në parathënie të tij. Filozofia e saj sugjeron një menaxhim ndryshe të shoqërisë njerëzore, një organizim ndryshe të institucioneve sociale, publike a jo publike, shtetërore qofshin a fetare. Asgjë më tepër se një kujdes të institucionalizuar të njeriut për njeriun, të njeriut për veten e vet.

Mund të tingëllojë si kontradiktore fjala “*kujdes*” në kontekstin moral të veprës së Nënë Terezës ku vendin më të dukshëm e ka fjala “*lutje*” dhe fjalët “*përvuajtje, bindje, sakrifica*” në ngjashmëri me vuajtjet e Krishtit. Ndoshta, në këtë dukje kontradiktore qëndron thelbi i filozofisë praktike të Nënë Terezës: ai thelb që u kërkon njerëzve asgjë më tepër se sa t’i “*buzëqeshni njëri-tjetrit!*”. Pra, me përvuajtje, me bindje, me sakrifica njerëzit t’u largohen xhelozirave, inateve, konflikteve, luftërave. Me përvuajtje, bindje dhe sakrifica t’i buzëqeshin edhe atij të vetmuarit, të pamundurit nga mplaçja, sëmundja, varfëria...

Dikush edhe mund të kundërshtojë: por kjo nuk është filozofi, është këshillë, është moral, madje moral i krishterë, pasi shenjtëresha Nënë Tereza ishte vetë një fetare praktikante e devotshme dhe rekomandonte lutjen drejtuar Zonjës së Bekuar, Krishtit, Zotit. As teologët, përgjithësisht nuk i argumentojnë idetë dhe veprimtaritë e Nënë Terezës të cilësuaa filozofikisht. Edhe Nënë Tereza asnjëherë nuk është shprehur se po filozofon, sepse ajo me shembullin e saj dhe të pasuesve të vet, pikërisht atë filozofi të derisotme që e ka katandisur botën në këtë gjendje kërkon të reformojë, atë mentalitet dhe atë moral të derisotëm kërkon të tejshkojë.

Por kush tenton të përmbysë një filozofi të tërë për jetën, propozon një filozofi të re. Filozofia e re e Nënë Terezës bazohet në vlerat e vërteta morale të vetë njerëzve që mendojnë dhe veprojnë si ajo, si motrat e saj, si vëllezërit e saj (përfshirë edhe motrat e vëllezërit laikë), si të gjithë duan të jetojnë më mirë. A nuk kemi të bëjmë me një sistem të ri idesh filozofike për jetën dhe vdekjen mbi tokë, një sistem llogaritjesh për lumturinë humane, një sistem përfundimesh për marrëdhëniet e njerëzve me njëri-tjetrin dhe me mjedisin modernist që i rrethon, gjëra këto që është rrekur t’i shpëtojë filozofia deri në ditët e sotme, por pa sukses? Nënë Tereza e ka vulosur suksesin e ideve të veta me veprimtarinë e saj dhe të institucioneve të ngritura prej saj. Ajo thoshte:

“Atyre që janë në prag të vdekjes mundemi që të paktën t’u japim përshtypjen e vërtetë të një gjëje shumë të rëndësishme: që ekziston dikush i gatshëm për t’i dashur me të vërtetë dhe me faktet, sepse dhe ata, si gjithë të tjerët ose, ndoshta, me të drejta më shumë se të tjerët, janë bij të Zotit dhe meritojnë të duhen.”

2. Tre tregime të vërteta (ose pjesërisht të vërteta) nga jeta e Nënë Terezës

Tregimi i parë: Një vakt si zotërinjtë

Nënë Tereza që ftuar në njërin prej banketeve që shtroni herë pas here disa ish-nxënese të saj nga familje të kamura të Kalkutës. Ndryshe nga ç’e kishte zakon në raste të tilla, ajo qëndroi deri në fund. Kur u larguan të ftuarit dhe kamerierët

filluan të mbledhin çfarë kishte mbetur ndër pjatancat, ajo iu drejtua vajzave që kishin organizuar festën:

– U thoni këtyre që ngrënë tryezat, t’i mbledhin për mua ushqimet e paprekura, ëmbëlsirat e mbetura dhe frutat. Do të dërgoj menjëherë njerëz t’i marrin për fëmijët e mi të uritur e pleqtë e sëmurë. Ah, sa do të kënaqen duke ngrënë gatime për zonja e zotërinj, qoftë edhe në një vakt të vetëm të jetës së tyre!

Dhe ashtu u bë. Dhe jo vetëm pas asaj gostie. Ishte ose jo e ftuar Nënë Tereza, njerëzit e saj lajmëroheshin thujse sa herë shtroheshin bankete të tilla...

Tregimi i dytë: Dialog me President

– Do të kujdesem që të marrësh një çek me disa milion dollarë për institucione e

tua, - i tha Presidenti Regan Nënë Terezës në Washington kur po e shoqëronte me rastin e një vizite zyrtare.

– Jo, - ia priti Nënë Tereza me një vendosmëri të pafajshme, - nuk i pranoj. Nuk marr çeqe nga qeveritë. Nuk kam marrë asnjëherë. As nga institucionet fetare.

– Si kështu?! Me se i mban shtëpitë e bamirësive në të katër anët e botës?

– Me donacione prej institucioneve jo shtetërore e jo fetare, si dhe me dhuratat

individësh. Qeveria Amerikane, p.sh. (ose një institucion fetar i çfarëdo rangui), me ato dollarë, që më ofron mua, le të bëjë vetë diçka më tepër për shtëpitë e pleqve, spitalet e të varfërve dhe fëmijët e braktisur.

– Kuptova, - u tërhoq Presidenti. - Unë do të jap disa mijëra dollarë nga të ardhurat e mijës personale. Kështu mundem?

– Po. Dhe unë me motrat e mia do t’i menaxhojmë ata dollarë, sa të jetë e mundur më mirë, në dobi të nevojtarëve më në nevojë.

Tregimi i tretë: Një kryq për lutje me dy shkopinj

Thjeshtësia e Nënë Terezës ka qenë proverbiale. Nënë Tereza ishte edhe racionale, tepër madje. Thjeshtësia e bente të ishte pa kurrfarë pretendimi vetjak, ndërsa racionlitet i siguronte në çdo rast eficientë maksimale të bëmvave të saj (dhe të motrave të saj). Kështu, Nënë Tereza nuk humbiste kohë as për të zgjedhur një altar kishe sa herë e ndiente të nevojshme të lutej. Ndodhte që ajo merrte dy shkopinj, krijonte me to një kryq, e vendoste atë kryq mbi tryezë dhe ulej në gjunjë përballë tij, duke mbështetur kokën mbi të dy duart e veta të bëra bashkë.

Motrat e saj, kur e shihnin ashtu, ose i bashkoheshin në lutje, ose shpejtonin të arrinin sa më parë aty ky e dinin se në atë çast një qenie tjetër njerëzore kishte nevojë për ta. Pas lutjes, atje do të mbërrinte menjëherë edhe Nënë Tereza.

Gazetarët, më se një herë, e kanë pyetur qortueshëm:

– Po ju, përse humbisni kohë pa fund duke ia çuar nevojtarëve peshkun në pjatë? A nuk do të ishte më mirë t’u dhuronit atyre një kallam peshkimi dhe t’u mësonit ta zinin peshkun vetë?

Edhe ajo ia kthente jo pa ironi:

– Ashtu është vërtetë, por ne, motrave, na duhet t’u ndihmojmë nevojtarëve

pse janë të pamundur. Kështu që, më parë, ata duhen të bëhen të aftë ta mbajnë vetë lugën në dorë e tyre dhe, më pas, kallamin që propozoni ju për peshkim...

Duke përfunduar këtë qasje për Nënë Terezën, e falënderoj edhe një herë filatelistin Hysen S. Dizdari, i cili me punën e vet pasionanate dhe sistematike na e ka afuar më afër Nënë dhe vepren e saj madhështor

“MIKPRITJA E NJË POPULLI QË KËRKON LIRI”

Prishtinë , 18 janar 2020



Promovimi i librit “Mikpritja e një populli që kërkon liri”, organizuar në Kosovë më 18 janar 2020 vjen pas një muaji të promovimit të tij së pari në qytetin e Shkodrës, pikërisht më 11 nëntor 2019.

Shtysë për botimin dhe promovimin e librit në Shkodër bëhet përkujtimi i 20-vjetorit të angazhimit tonë kundrejt refugjatëve nga Kosova. Në këtë promovim ishte i pranishëm edhe Imzot Dodë Gjergji.

Ndër të tjera, në fjalën e tij, Imzot Angelo Massafra, i propozoi Imzot Dodë Gjergjit që promovimi i librit të bëhej edhe në Kosovë.


Imzot Doda e vlerësoi këtë ide dhe nën kujdesin e tij organizoi promovimin e librit “Mikpritja e një populli që kërkon liri - 20-vjetori i angazhimit tonë kundrejt refugjatëve nga Kosova”, më 18 janar 2020 në Kosovë, inkuadruar brenda programit “Akademi solemne - Faleminderit Shqipëri”, mbajtur në Qendrën “Bogdani Polis” Prishtinë.

Në prani të shumë autoriteteve shqiptare dhe kosovare, si edhe të shumë të pranishmëve të moshave të ndryshme, u bë edhe paraqitja e librit në fjalë, që, për hir të së vërtetës, kishte një tjetër shije prej promovimit në Shkodër, prej faktit se tani bëhej pikërisht në atë vend dhe në prani të atyre njerëzve, që i kishin përjetuar personalisht tmerret e luftës dhe mikpritjen e vëllezërve të tyre 20 vite më parë.

Në këtë takim ishin të pranishëm nga Shqipëria si dhe morën fjalën: Imzot Angelo Massafra, Atë Flavio Cavallini, Loreta Toma dhe Moter Valbona Hajdari.

Loreta Tomaj






PAPA FRANÇESKU

KRISHTI JETON

*Arqipeshkvia Shkodër - Pult
Prishtinë 2019*



**MIKPRITJA E NJË POPULLI
QË KËRKON LIRI**

**Arqipeshkvia Metropolitane
Shkodër - Pult 2019**



AT BERNARDIN PALAJ OFM

**BOTA E MALEVE
SHQIPTARE**

*Botimet Françeskane
Shkodër 2018*

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXIII, nr. 1/2 (527-528) Janar - Shkurt 2020